

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7768 E shtunë 19 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga VETON SURROI



Përgatituni të dëgjoni këngën e bashkimit

Në vitin 2018 u legjitimua fjala "korrigjim" (eufemizëm për ndarje dhe këmbime territore në baza etnike), ndërsa sapo kemi hyrë në vitin kur ...  
Vijon në faqen 20

Opinion i Ditës

Nga BEN ANDONI



A ka mbaruar e Majta shqiptare prej vitit '90?!

Mënyra sesi po sillet qeveria e kryeministrit Edi Rama, por edhe sesi vepron ajo e paraardhësve të tij, tregon se e Majta si koncept ideologjik në vendin ...  
Vijon në faqen 21



"Pse kërkojmë të zgjatet 3 muaj hetimi"

## "Tahiri ka siguruar paprekshmërinë e Habiliajve", dyshimi në dosjen e prokurorisë

Zbardhet vendimi, hetuesit kërkojnë prova të reja nga Mali i Zi dhe Italia për ish-ministrin

TIRANË-Prokuroria e krimeve të Rënda ka vendosur shtyrjen me 3 muaj të tjerë të afatëve të hetimit ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, i akuzuar për "Trafikim i narkotikëve", kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal dhe "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ..."

Në faqen 7

SHKARKOHET DITMIR BUSHATI. KRYEMINISTRI "MERR" EDHE DIPLOMACINE

# META DEKRETON EDI RAMEN MINISTER: SHMANGA KRIZEN

Presidenti: Kushtetuta as e parashikon, as e ndalon. Ruçi: E prisja këtë vendim, jemi në republikë parlamentare. Berisha: Meta dekretoi albanofobin, ditë e zezë



(Në foto) Ish-ministri i Jashtëm Ditmir Bushati dhe Kryeministri Edi Rama

Në faqen 3

KRIMI

Vrasja në Korçë, shërri mes dy të rinjve për makinën në rrugë

Në faqen 6

ARSIMI I LARTE

Edi Rama: Pakti për Universitetin, dialogu me studentët duhet të vazhdojë

Në faqen 5

KATEGORITE

Ndryshime në listën e barnave me rimbursim, ja kush përfiton

Në faqen 9

LISTA E KRITEREVE

Pasaporta greke, kush përjashtohet nga e drejta për të aplikuar

Në faqen 11

MBLIDHET KESHILLI



Emrat, zbardhet lista e kandidatëve për sekretariatit dhe kryesinë e PD

Në faqen 4



Transformimet në një dekadë që pësuan personat e famshëm të showbizz-it

## 'Sfida e Instagramit', "fytyra" e vërtetë e VIP-ave

Noizy dhe Tayna, ja kur vjen bashkëpunimi i ri. A u shty programi "E diell"?

NGA PAMELA ALIAJ

Nuk është hera e parë që sfidat apo tendencat më të reja të rrjeteve sociale na marrin mendjen duke na përfshirë në vorbullën e tyre. E tillë është edhe sfida më e re e 'Instagramit', për të postuar foto para 10 viteve. Për



të qenë të singertë jo të gjithë e marrin përsipër të përfshihen në këtë sfidë sepse do pak kurajë. Kjo jo sepse kemi komplekse të shfaqim të shkuarën, por të nxjerrim në shesh të vërtetën e ndryshimeve drastike të pamjes së tanishme. Kjo gjë ka ndodhur edhe më ...

Suplement

## KONFLIKTI DEKRETIMI

Kreu i Kuvendit ka bërë analizën e jetës parlamentare për vitin që lamë pas

# Ruçi: S'jam bërë pishman për Metën, të shprehej me dekret për Cakajin

"Rama në të drejtën e tij për të ndryshuar qeverinë"

Pavarësisht konfliktit që ka krijuar me kryeministrin sa i përket dekretimit të ministrave, kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi nuk është penduar për votën që i dha Ilir Metës rreth dy vite më parë për ta zgjedhur President të Republikës. Gjatë një bashkëbisedimi me gazetaret, lidhur me arritjet parlamentare të vitit që lamë pas, kryeparlamentari, Gramoz Ruçi ka folur edhe për debatin më të fundit të krijuar mes mazhorancës ku ai bën pjesë dhe institucionit të presidentit, por duke mos shprehur asnjë pendesë për zgjedhjen që bën me Metën. "Unë nuk jam pishman për votën që jap dhe për qëndrimet që mbaj në këtë çështje dhe, sigurisht, nuk kam pritur që Presidenti i Republikës, kushdo të ishte ai, edhe zoti Meta, të operojë gjatë përbushjes së detyrës së tij sipas orekseve politike, elektorale apo partiake të asnjë pale", - u shpreh kryetari i Kuvendit. Por ai theksoi se kjo nuk do të thotë që ai të mos presë nga presidenti që të zbatojë Kushtetutën. "Kam pritur dhe pres që zoti Meta të zbatojë Kushtetutën si President i vendit dhe vetëm kaq. Për këtë nuk kam se pse të jem pishman", - shtoi Ruçi. Ndërkohë sa i përket debatit konkret nëse duhet të dekretojnë ose jo Meta emrin e Gent Cakajit si ministër të Jashtëm, Ruçi i është referuar nenin 93 të Kushtetutës, ku theksohet se Presidenti i Republikës shpreh vetëm me dekret. "Neni 93 i Kushtetutës thotë: "Presidenti i Republikës në zbatim të kompetencave të tij nxjerr dekrete ose shpreh me dekret". Pra, unë nuk e vë fare në diskutim a ka të drejtë Presidenti të thotë po ose jo, por ajo që thotë Kushtetuta është që presidenti për të gjithë kompetencat që ka duhet të shprehet me dekret. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që, siç e lexoj unë Kushtetutën, edhe kur jep pëlqimin, edhe kur nuk e jep pëlqimin, pra ka kundërshtim, duhet të nxjerrë dekret", - theksoi kryeparlamentari. Ndaj në këtë aspekt ai ka vlerësuar se presidenti du-



Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi

### PËR CAKAJIN

"Kryeministri, sipas Kushtetutës, bën propozimin, presidenti, sipas leximit që i bëj unë, jep pëlqimin, parlamenti nxjerr vendimin, qoftë për shkarkimin, qoftë për emërimin, qoftë për pëlqimin, qoftë për mospëlqimin"

## Kuvendi hap të hënën sesionin parlamentar, votohet Rama si ministër

Të hënën në orën 17:00 do të hapet zyrtarisht sesioni i IV i Legjislaturës së IX të Kuvendit të Shqipërisë. Njoftimi është bërë në faqen zyrtare të Kuvendit, ku është bërë publik edhe rendi i ditës. Dy nga pikat e rendit janë dekretet e Presidentit Meta për shkarkimin e Ditmir Bushatit si ministër i Jashtëm dhe votimi i dekretit për emërimin e Kryeministrit Edi Rama edhe si ministër të Jashtëm. Pas këtij momenti Kreu i qeverisë duhet të ballafaqohet edhe një herë me presidentin Meta, pasi do duhet të shkojë që të be-tohet për të marrë zyrtarisht detyrën e re të ministrit të Jashtëm. Kjo do jetë



hera e parë që ata ballafaqohen fizikisht me njëri-tjetrin pas një fushate akuzash e kundërakuzash. Nga ana tjetër, nuk dihet nëse opozita do jetë e pranishme në seancë, pasi bashkë me aleatët morën një vendim dyditë më parë, duke deklaruar se do të nisë sezonin e

protestave deri në rrëzimin e qeverisë. Seanca e së hënës e Kuvendit të Shqipërisë shënon çeljen e sesionit normal parlamentar, pasi të mërkurën e shkuar Kuvendi u mblood në një seancë jashtë radhe në sesion parlamentar të jashtëzakonshëm.

duke i zëvendësuar ata me ministra kryesisht teknik. Sipas Rugit kjo është brenda filozofisë së alternativës me të cilën PS u paraqiti në zgjedhje. "Çdo parti që vjen në pushtet nuk vjen me votat e anëtarësisë së vet, se maksimumi, çdo parti në Shqipëri ka 100 mijë anëtarë, ndërkohë duhen mbi 700 mijë vota për të qenë në pushtet. Në dijeninë time, nuk ka as-



Kryeministri Edi Rama dhe presidenti Ilir Meta



### PËR OPOZITËN

"Apeli që kam unë: vendi ku zhvillohet opozitarizmi më produktiv, kjo edhe nga përvoja ime, është salla e Kuvendit. Shpresoj dhe besoj që lufta opozitare të jetë në sallën e Kuvendit"



### PËR PROTESTËN

"Opozita nuk merr leje as nga unë, as nga ju që të zhvillojë protesta, është normë demokratike. Do ndikoj që të garantohet hapësira, legjitimiteti dhe normaliteti i këtyre aktiviteteve opozitare"

## Vasili: Rama e Ruçi fosile të së shkuarës, rënia çështje kohe

Kryetari i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili ka sulmuar ashpër kryeministrin Edi Rama dhe kryetarin e Kuvendit Gramoz Ruçi, ndërsa i cilëson ata si fosile të së shkuarës. Përmes një postimi në rrjetet sociale Vasili tha dje se Rama e Ruçi janë kthyer në armiq të popullit. "Rilindja, Rama, Ruçi (RRR) dhe partia në pushtet mbi shtetin e së drejtës! Shteti i së drejtës për këta fosile e të shkuarës nuk ekziston dhe përmbi të është partia në pushtet, siç thotë ky Ruçi. Për këta armiq të popullit, qytetarët nuk duhet t'i besojnë ligjit dhe shtetit ligjor. Këta armiq të ligjit duan që qytetarët t'i gjuhëzohen shtetit të partisë në pushtet, të rilindjes së kriminelëve, trafikantëve, pas-truesve të pasurisë së pisë dhe dhunuesve të ligjit", - shkroi Vasili. Më tej ai shprehej në statusin e tij se rënia e qeverisë dhe kësaj mazhorancës është vetëm çështje kohe. "Tre "R" Rilindja, Rama, Ruçi, janë dëshmitarë se si partia që ishte mbi ligjin u shpërbë në 2 javë nga studentët në vitin 90?, ndërsa rrëzimi i rilindjes, partisë së vdekur të këtyre është thjesht një funeral i vonuar që shqiptarët do ta përfundojnë shumë shpejt", - shkruante më tej Vasili.





Presidenti firmos dekretet, shkarkohet Bushati, kryeministri në krye të diplomacisë

# Rama si ministër i Jashtëm. Meta: Shmanga krizën institucionale

*"Rast i veçantë, s'parashikohet dhe as ndalohet nga Kushtetuta"*

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta dekretoi dje kryeministrin Edi Rama edhe në postin e ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme, pas shkarkimit të Ditmir Bushatit, që ka mbajtur këtë detyrë deri tani. Debatit të krijuar në ditët e fundit nëse e lejon Kushtetuta që kryeministri të mbajë edhe postin e ministrit, kreu i shtetit i përgjigjet duke sqaruar se, "është një rast i veçantë, që nuk parashikohet dhe as ndalohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë". Në njoftimin e shpërndarë për mediat, zyra e shtypit të Presidentit thekson se dekreti është firmosur nga Meta "duke mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e evitimit të çdo mundësie për krijimin e një krize institucionale, e cila do të dëmtonte pozitën e Republikës së Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare". Megjithatë, kreu i shtetit thekson se, "ushtrimi i detyrës së ministrit nga kryeministri është një veprimtari shtetërore, që shtrihet brenda sferës ekzekutive, pjesë e kabinetit qeveritar, struktura e të cilit është në të drejtën e kryeministrit për t'u propozuar". Meta shprehjet se emërimi i Ramës në krye të diplomacisë është një rast i veçantë, por që nuk përbën shkelje të Kushtetutës.

"Emërimi i kryeministrit edhe në detyrën e ministrit është një rast i veçantë, që nuk parashikohet dhe as ndalohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në shqyrtimin e këtij propozimi, Presidenti i Republikës, në cilësinë e kreu të shtetit, ka mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e evitimit të çdo mundësie për krijimin e një krize institucionale, e cila do të dëmtonte pozitën e Republikës së Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93 dhe 98 pika 1 të Kushtetutës, sot më datë 18.01.2019, ka vendosur me dekret që Z.Ditmir Bushati, ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, shkarkohet nga kjo detyrë dhe zoti Edi Rama, kryeministër, emërohet edhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme", thuhet në njoftimin e



Presidenti Ilir Meta

## "Presidenti dekretoi albanofobin"

# Rama ministër i Jashtëm, Berisha: E premtë e zezë, grusht shteti!

Ish-kryeministri Sali Berisha e quajti ditën e djeshme, një të premtë të zezë, referuar dekretit të Presidentit Ilir Meta për Edi Ramën ministër të Jashtëm. Berisha shprehjet se dekretimi i Ramës si ministër është një akt antikushtetues dhe grusht shteti. Për Berishën, dekretimi është antikushtetues dhe merr për bazë pikën D, në nenin 102 të Kushtetutës, kryeministri kufizohet të kryejë detyra të tjera përveç atyre që bazohen në Kushtetutë. "Presidenti i Republikës dekretoi albanofobin, antishqiptarin e mirëfilltë, njeriun që në popull masivisht e thërrasin Zografi Bis si ministër i jashtëm i Shqipërisë. Kjo sepse kësaj here, njëlloj si Jorgo Kristakis Zografi 105 vite më parë, që për llogari të magalides shpalli autonominë e zonave jugore të vendit, Edvin Kristakis Rama me marrëveshjen e tij i fali Greqisë 2100 km det dhe tril-



Ish-kryeministri Sali Berisha

### AMENDIMI

"Rama, për të marrë portofolin e ministrit të Jashtëm duhet që të amendonte Kushtetutën, e cila qëllimisht nuk ka parashikuar që kryeministri të marrë edhe detyrën e ministrit", tha Berisha.

ionë metër kub gaz dhe fuçi naftë, pasuri përrallore nëndetare të popullit shqiptar. Edvinin shqiptarët e konsiderojnë dhe e thërrasin rëndom Zografi bis, sepse ai është flamurmbajtës në Tiranë i idesë së Serbomadhisë, iniciator i projektit të copëtimit, tregtimit të territoreve të Kosovës. Kjo është një e

premtë e zezë në historinë e kushtetutshmërisë dhe triumf i grushtit të shtetit brenda shtetit dhe kjo sepse Kushtetuta e Shqipërisë neni 102 pika "d" sanksionon "se kryeministri dhe jo zëvendëskryeministri, "kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje", shprehjet z.Berisha.

presidencës. Me dekretin e djeshëm merr fund, të pakten për momentin, përplasja institucionale mes Presidencës dhe qeverisë, e cila nisi pas refuzimit që Meta i bëri emrit të Gent Cakajt në postin e ministrit të Jashtëm. Kryeministri ka paralajmëruar se çeshtjen nëse Presidenti ka të drejtë që të kthejë dekretet do ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese. Tashmë pritet që në seancën e radhës, që është në datë 21 janar të firmosen dekretet e shkarkimit të Bushatit dhe të emërimit të kryeministrit

Edi Rama edhe në postin e kryediplomatit të Shqipërisë. Kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar se do përballet me Metën në Kushtetuese, pas vendimit të këtij të fundit për të mos dekretuar Gent Cakajn si ministër të Jashtëm.

Edi Rama edhe në postin e kryediplomatit të Shqipërisë. Kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar se do përballet me Metën në Kushtetuese, pas vendimit të këtij të fundit për të mos dekretuar Gent Cakajn si ministër të Jashtëm.

### DEKRETI

Kreu i shtetit, Ilir Meta shkarkoi dje Ditmir Bushatin, duke miratuar dekretin për Edi Ramën si ministër të Jashtëm. Meta shprehet se emërimi i Ramës në krye të diplomacisë është një rast i veçantë, por që nuk përbën shkelje të Kushtetutës.



## Kryemadhi, thirrje shqiptarëve: S'ka më kohë, ngrihuni në protesta dhe revolta

LSI mbledhi dje Komitetin Kombëtar Drejtues për të nisur organizimin e protestave për të larguar qeverinë Rama. Monika Kryemadhi i bëri thirrje çdo qytetari që sipas saj kërkon një Shqipëri më të mirë që të dalë në shesh kundër asaj që ajo e quan organizatë kriminale. "Dua të bëj një sqarim sa u përket anëtarëve të Komitetit Drejtues, që vijnë nga qarqet e tjera jashtë Tiranës. Detyra juaj është se nuk ka më kohë për të pritur, bëhuni gati për zgjedhje të përgjithshme, për zgjedhje lokale, për revolucion, për revolta, për protesta, për koncerte për çfarë të doni ju. Sot nuk ka më asnjë sekondë për të pritur. Sot kush ka dëshirë që të ketë një jetë më të mirë për fëmijën e tij, kush ka dëshirë që të ketë një punë të paguar për punën që bën, kush ka dëshirë që biznesi i tij mos fallimentojë, kush ka dëshirë që të ketë një shëndetësi të barabartë për të gjithë, kush ka dëshirë që të ketë një drejtësi të barabartë, kush ka dëshirë që të ketë një ekonomi të fortë, kush ka dëshirë të ketë infrastrukturë, kush ka dëshirë të ketë një shtet që t'i garantojë dhe të ketë një sistem që t'i mbrojë, nuk ka më kohë të presë, por të dalë në rrugë, të protestojë në të gjitha mënyrat, nga demokratike, të moderuara dhe kulturore", deklaroi zj.Kryemadhi. Kryetarja e LSI u shpreh më tej se rrëzimi dhe largimi i Edi Ramës përkthehet në krijim shansesh të barabarta për të gjithë shqiptarët. "Sot të gjithë faktorët politikë janë të kush-tëzuar që bashkohen me njëri-tjetrin për të rikthyer në shinat kushtetuese institucionet shtetërore, institucionet e kapura, duke filluar që nga Parlamenti i pari", u shpreh kryetarja e LSI.

# KËSHILLI KOMBËTAR ZGJEDHJET

Basha rikthen Nishanin në PD, shmang Ristanin, Paloka dhe Spaho sërish nënkryetarë

Valentina Madani

Demokratët përmes votës së fshehtë zgjedhin sot drejtuesit e rinj të partisë. 362 anëtarë të Këshillit të ri Kombëtar do të votojnë për njerëzit, të cilët do të drejtojnë këtë forcë politike për 4 vitet e ardhshme. Pjesë e votimit është zgjedhja e sekretarit të përgjithshëm, dy nënkryetarëve, 15 anëtarë të kryesisë, si dhe sekretariatet. Në një dalje për mediat, kreu i PD-së, Lulzim Basha bëri dje publike kandidaturat që do t'i propozojë sot Këshillit Kombëtar për zgjedhjen e kryesisë së partisë, zgjedhjen e sekretariatit ekzekutiv dhe funksional. Z. Basha njoftoi se pikë e dytë e rendit të ditës së Këshillit Kombëtar do të jetë diskutimi i gjendjes politike në vend. Basha bëri të ditur gjithashtu se sot do t'i propozojë Këshillit Kombëtar për kryetar kandidaturën e zotit Bujar Nishani dhe do të kërkojë votëbesimin për dy nënkryetarët në detyrë të zgjedhur apo të votëbesuar nga grupi parlamentar në të këtë sesion, zotit Paloka dhe zotit Spaho. Anëtarë ekskluzivë të kryesisë së PD-së, tha Basha, janë kryetari i Forumit Rinor të PD-së dhe kryetari e Lidhjes Demokratike të Gruas. Po kështu, Basha njoftoi se do t'i propozojë sot Këshillit Kombëtar Halim Kosovën si kryetar i Komisionit të Integritetit dhe Etikës, Jemin Gjanën si kryetar të Komisionit të Zgjedhjes, Arben Ristanin si kryetar të Komisionit të Apelit dhe Alfred Rujshajn si kryetar të Bordit Financiar të PD-së.

**NDRYSHIMET**  
Referuar listës së plotë të kandidatëve të publikuar dje nga z. Basha, ndryshime të ndjeshme janë ato që prekin sekretarin e PD-së. Kështu, sekretari i përgjithshëm në detyrë, Arben Ristanin, nuk do rikandidojë më për këtë funksion. Basha ka propozuar garë mes Dorjan Telitit dhe Gazmend Bardhit për postin e rëndësishëm në PD. Edhe Enno Bozdo nuk do jetë më sekretar organizativ. Në vend të tij i janë propozuar Këshillit Kombëtar emrat e Sahit Dollapit dhe Lulzim Omurit. Ndërsa emri i ri që bëhet pjesë e PD-së është ai i Çlirim Gjatës, ish-kryetar i KQZ-së i cili kandidon për sekretar të çështjeve ligjore përballë Marinela Ziut. Ndërsa sekretariati për çështjet zgjedhore do të ndahet mes Ivi Kasos dhe Dorjan Gjonmarkaj. Lidhur me numrin dy të PD-së, Lul-

## PD, zbardhet lista e kandidatëve për kryesinë dhe sekretariatit

Në garë, Bardhi, Salianji, Teliti e Gjata



Kreu i PD-së Lulzim Basha

### KRYESIA E PDSH-SË

- **Neni 52**  
Kryesia e PDSH-së përbëhet nga:
  1. Kryetari i partisë.
  2. Nënkryetarët e partisë.
  3. Sekretari i përgjithshëm dhe sekretarët funksionalë, të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.
  4. Kryetarët e organizatave partnere.
  5. 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë të zgjedhur me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar, nëpërmjet një numri kandidaturash të paktën sa dyfishi i numrit të vendeve vakante.
  6. Zëdhënësi i Partisë si dhe sekretari për Marrëdhëniet Ndërkombëtare që emërohen nga kryetari i PDSH-së.

### LISTA E PLOTË, KANDIDATËT PËR 15 ANËTARËT E KRYESISË SË PD

- |                       |                       |
|-----------------------|-----------------------|
| 1. Agron Shehaj       | 26. Gent Strazimiri   |
| 2. Aldo Bumçi         | 27. Genti Malko       |
| 3. Arben Beqiri       | 28. Gerti Bogdani     |
| 4. Arben Ibro         | 29. Grida Duma        |
| 5. Avenir Peka        | 30. Izmira Ulqinaku   |
| 6. Bardh Spahia       | 31. Jamarbër Malltezi |
| 7. Besart Kadia       | 32. Jordita Tabaku    |
| 8. Dhurata Çupi       | 33. Kastriot Sulka    |
| 9. Dritan Shani       | 34. Klevis Balliu     |
| 10. Dorjan Gjonmarkaj | 35. Lendina Mandia    |
| 11. Endri Hasa        | 36. Luçiano Boçi      |
| 12. Enkelejd Alibeaj  | 37. Lindita Metalia   |
| 13. Enkelejd Sallaku  | 38. Mateo Spaho       |
| 14. Enno Bozdo        | 39. Nada Meçorapja    |
| 15. Ervin Çano        | 40. Nevila Xhindi     |
| 16. Ervin Salianji    | 41. Ndrigim Mehmeti   |
| 17. Fatbardh Kadilli  | 42. Oerd Bylykbashi   |
| 18. Fatbardha Kadui   | 43. Orjola Pampuri    |
| 19. Fatbardh Sallaku  | 44. Roland Bejko      |
| 20. Fitim Zekthi      | 45. Rudina Hajdari    |
| 21. Flamur Hoxha      | 46. Tomor Alizoti     |
| 22. Flamur Noka       | 47. Tritan Shehu      |
| 23. Florian Mima      | 48. Valentina Duka    |
| 24. Gazmend Kozdri    | 49. Xhemal Gjunkshi   |
| 25. Genc Pollo        |                       |

zim Basha kërkon votësim për Edi Palokën dhe Edmond Spahon, të dy si nënkryetarë, duke mospreferuar kandidimin e një emri të ri në pozicionin e bashkëpunëtorëve më të afërt. Pas konstituimit të kryesisë dhe sekretariateve, do jenë deputetët, ata që do zgjedhin kreun e ri të grupit parlamentar. Me ndryshimet në statutin e Partisë Demokratike, të miratuara prillin e vitit të kaluar, 15 anëtarë të kryesisë do të votohen nga këshilli, një model ky i ndryshëm nga ai që Basha zgjodhi në mandatin e parë si kryetar partie e që është i njëjtë me modelin e Berishës. Sipas statutit, të gjitha kandidaturat për

këto poste i cakton kryetari i partisë.

#### TAKIMET

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, prej disa ditësh ka thirrur në zyrë kandidatët që ai ka menduar për t'ia propozuar sot Këshillit Kombëtar. Për disa nga postet kyçe, kreu i PD-së mësohet të ketë zhvilluar ditët e fundit takime të veçanta për të konfirmuar vullnetin e kandidatëve për

të garuar në këto pozicione. Vendimi i Bashës për të thirrur Këshillin Kombëtar të PD-së dhe për të përzgjedhur lidhshpër të ri shënon edhe fundin e procesit të riorganizimit të PD-së, të nisur që pas humbjes së zgjedhjeve në vitin 2017. Ndryshe nga kryesia, që funksionoi mandatin e parë të Bashës në krye të partisë, në të cilin anëtarët ishin pjesë e këtij organi për shkak të detyrave që mbanin, këtë herë më shumë se gjysma e anëtarëve do të votohen. Sipas statutit të ri të PD-së, të miratuar në prill 2018, anëtarët e Këshillit Kombëtar do të zgjedhin në kryesinë e PD-së me votim të fshehtë 15 anëtarë, nëpërmjet një numri kandidaturash të paktën sa dyfishi i numrit të vendeve vakante. Kryesia e re, e cila do të dalë nga votat e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të PD-së, do të ketë vendimmarrje të drejtpërdrejtë në përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet vendore. Statuti i ri i PD-së parashikon që Kryesia të vendosë për kandidatët për kryetarë bashkie, kandidatët deputetë, pas konsultimit me anëtarësinë e plotë të PDSH-së sipas parimit "Një anëtar, një votë" dhe kandidatët për kryetarë të degëve të PDSH-së.

### KANDIDATËT PËR SEKRETARIATIN E PD

- **Sekretariati organizativ :**  
Gazment Bardhi - Dorjan Teliti, sekretar i përgjithshëm.  
Çlirim Gjata - Marinela Ziu, sekretar për çështjet ligjore.  
Sahit Dollapi - Lulzim Omuri, sekretar organizativ.  
Ivi Kaso - Dorjan Gjonmarkaj, sekretar për çështjet zgjedhore.  
Ervin Minaroli - Minushë Lazaj, sekretar për burimet njerëzore.
- **Propozime për organe statutorë**  
Bujar Nishani - kryetar i Këshillit Kombëtar.  
Halim Kosova - kryetar i Komisionit të Integritetit dhe Etikës.  
Jemin Gjata - kryetar i Komisionit të Zgjedhjes.  
Arben Ristanin - kryetar i Komisionit të Apelit  
Alfred Rujshaj - Kryetar i Bordit Financiar.
- **Kërkesë për votësim:**  
Edi Paloka - nënkryetar  
Edmond Spaho - nënkryetar
- **Anëtarë të kryesisë ex-officio:**  
Kryetarja e LDG, Albana Vokshi  
Kryetari i FRPD, Belind Këllici  
Propozim për kryetar i Këshillit Kombëtar: Bujar Nishani

### STATUTI I PARTISË DEMOKRATIKE

- **Kompetencat e Këshillit Kombëtar**  
**Neni 50**  
1. Këshilli Kombëtar drejtohet nga kryetari i këshillit, i cili zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Kombëtar, në mbledhjen e tij të parë të konstituimit, për një mandat 4-vjeçar.  
2. Mbledhjen e Këshillit Kombëtar e thërret kryetari i partisë, ose kryetari i Këshillit me miratim të kryetarit të partisë, pas konsultimit me kryesinë e partisë. Këshilli Kombëtar mund të mbledhet edhe nëse e kërkonjë 1/4 e anëtarëve të tij. Në këtë rast, kryetari thërret mbledhjen jo më vonë se dy javë nga data e depozitimit të kërkesës. Këshilli Kombëtar, si rregull, mbledhet jo më pak se një herë në vit. Data e mbledhjes dhe rendi i ditës duhet t'u njoftohen anëtarëve jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes.  
3. Këshilli Kombëtar merr të gjitha vendimet e rëndësishme politike që mund të kërkojnë rrethanat kur Kuvendi Kombëtar nuk është i mbledhur dhe kur ato nuk janë parashikuar në këtë Statut si e drejtë vetëm e Kuvendit.  
4. Këshilli Kombëtar, me propozim të kryesisë së PDSH-së ose kryetarit të partisë, zgjedh dhe/ose shkarkon, me votim të fshehtë:  
a) Kryetarin e Këshillit Kombëtar.  
b) Sekretarin e përgjithshëm.  
c) Nënkryetarët e partisë.  
d) Anëtarët e zgjedhur të Kryesisë së PDSH-së.  
e) Sekretarët funksionalë.  
f) Komisionin e Apelitit.  
g) Kryetarin e Bordit Financiar të Partisë.  
5. Këshilli Kombëtar, me propozim të kryesisë së PDSH-së ose kryetarit të partisë, ushtron edhe këto përgjegjësi apo të drejta:  
a. Miraton Rregulloren e Brendshme dhe aktet e tjera të nevojshme nënstatutore për zbatimin e këtij statuti apo mirënjohjen e punës në parti.  
b. Miraton listën e kandidaturave elektorale sipas vendimit të Kryesisë së PDSH-së.  
c. Shpall masat disiplinore për anëtarët e Këshillit Kombëtar apo Kryesisë së PDSH-së, të cilat mund të ankohen pranë Komisionit të Apelitit.

### NJOFTIM

Në datë 05.02.2019 në orën 16.00 në zyrën e përmbareusit gjyqësor privat Irina Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhë, Njësia Tregliare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankand për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Trrali+Ndertese" me sip. Trruallit 220 m2 dhe sip.ndertese 97 m2, me nr.pasurie 11/23, volum 10, fage 229, zone kadastrale 8503, ndodhur në Lagja "Jani Vruho", Berat/Cmimi në ankand të dyte është në vlerën 2,296,000 (dy milion e dyqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.



Kreu i PD-së Lulzim Basha në Kuvendin Kombëtar të PD-së



Qeveria e re prezantoi Paktin për Universitetin para pedagogëve dhe studentëve

# Rama, pedagogëve: Merrni përgjegjësitë, problemi nuk janë studentët, por ju

## "Pëng qeverinë s'mund ta merrni dot duke bërë presione"

**M**e prezencën edhe të ministrave të rinj që sapo kanë marrë detyrën, qeveria ka prezantuar përpara një përfaqësie studentësh, pedagogësh dhe dekanësh e rektorësh draftin e Paktit për Universitetet. Nën drejtimin e ministres së re për Arsimin, Besa Shahini është bërë detajimi i dokumentit që sipas qeverisë shtron zgjidhje për çdonjërin nga 8 pikat e studentëve, por siç ka deklaruar kryeministri më parë, shkon përtej tyre, duke tentuar të trajtojë edhe një sërë çështjesh të tjera, që shqetësojnë sot arsimin e lartë në vend. Në fjalën e tij para studentëve dhe pedagogëve, kreu i qeverisë ka qenë i ashpër kryesisht me stafin akademik dhe drejtuesit e universiteteve, të cilët sipas tij, ndryshe nga qeveria që e ka pranuar përgjegjësinë e saj, nuk kanë reflektuar aspak në lidhje me pjesën që ata vetë duhet të bëjnë. "Nga ligji ju kërkoni liri, por nuk doni të merrni përgjegjësi. Ligji i arsimit të lartë ju jep liri, ju jep edhe përgjegjësi. Merrni përgjegjësinë dhe na thoni çfarë doni nga ne. Në dimër çfarë duan studentët dhe do t'i bëjmë një për një. Se çfarë doni ju, ne nuk e kemi kuptuar, ose më saktë unë e kam kuptuar, por nuk kam ndër mend ta them akoma", - tha kryeministri në fjalën e tij. Ai shkoi edhe më tej, duke u bërë të qartë pedagogëve dhe drejtuesve të universiteteve se nëse nuk reagojnë për të marrë përgjegjësinë që u takojnë, atëherë ai do bëjë me studentët për të luftuar kundër tyre. "Mos prisni ditën kur do bashkohem unë me studentët dhe t'u vij përballësh just dhe t'u them studentëve se çfarë në fakt ju nuk doni. Ju bëhuni bashkë tani dhe ndajeni këtë punë. Do të mbarojë historia e doktorëve të shkencave që vetëm me shkencë nuk kanë lidhje apo nuk do mbarojë? Ju edini shumë mirë për çfarë flas unë dhe e dinë shumë mirë sot se çfarë po ndodh. Nuk janë ata grupet e studentëve të ngjuar, problemi janë pedagogët që nuk shkojnë në japin mësim. Pse nuk shkojnë t'u japin mësim? Një student i vetëm ka të



Kryeministri Edi Rama gjatë prezantimit të Paktit për Universitetin

**PRESIONI**  
"Pëng qeverinë s'mund të merrni dot duke bërë presione, duke u fshehur, duke mos bërë mësim. Unë për veten time këtë protestë nuk e lë sikur të ngelem vetëm. Jam i gatshëm t'i mbaj të gjitha përgjegjësitë, edhe për borën që bie, por për budalla mua njeri dot nuk më bën".

### PAKTI PËR UNIVERSITETIN

- Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkolimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të cilit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, për vitin akademik 2018-2019 dhe në vijim, paguhet nga studentët në masën 50% të vlerës aktuale.
- Përfshihen nga tarifa vjetore: Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë). Studentët e pranuar në vitin e parë akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i ansimit të mesëm.
- Studentët me aftësi të kufizuara, fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të cilit të dytë të studimeve do të paguhajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve.
- Janë parashikuar rreth 300 milionë lekë shtesë për kryerjen e investimeve në infrastrukturën e konvikteve për vitin 2019.
- Njëpërmjet financim prej 16.8 milionë euro nga Qeveria Gjermane do të mundësohet rehabilitimi i një numri maksimal prej 13 ndërtesash të rezidencave studentore universitare në Tiranë.
- Do ngrihen portali i 'transparencës' dhe ankesave ku do publikohet 'online' të ardhurat dhe shpenzimet e universiteteve, vendimet e bordit dhe senatit, si dhe do të ngrihen zyra pranë MASR-së për transparencën.
- Do të rihapet procesi i zgjedhjeve për Këshillat Studentorë, si dhe do të bëhet monitorimi i Komisioneve të Përhershme dhe përfaqësimit në të studentëve në përputhje me statutin.
- Do bëhet kontrolli antiplagjatorë dhe rishikimi i titujve akademik, si dhe do të miratohet ligji i ri Kodit të Spjellsjes dhe Integritetit në Kërkimin Shkencorë. Do krijohet arkivi digital i diplomave.
- Shkarkimi i të gjithë anëtarëve të bordeve të emëruar nga MASR dhe emërimet e reja do të bëhen më një proces të hapur dhe më vëmendje publike. Njëri prej anëtarëve që emërohet prej MASR, të vijë propozim nga studentët, por të jetë figurë publike në përputhje me ligjin.
- Lëshimi i Kartës për çdo student të regjistruar në vitin akademik 2019-2020
- Do të ngrihen grupet e punës që do të realizojnë procesin e vlerësimit të performancës në mësimdhënie të personelit akademik, duke siguruar që anëtarët të këtyre grupeve të punës të jenë edhe përfaqësuesit e studenteve.
- Do krijohet një portal elektronik për ndjekjen e denoncimeve dhe ankimeve të studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ të IAL-vë.
- Përtej krijes së subvencionimit për mbështetjen e studentëve (tjllje efektive e tarifave), qeveria angazhohet për krijes e financimit për arsimin e lartë, duke synuar arrijen e mesatares së vendeve të rajonit deri në vitin 2023.
- Punësimi i 1000 studentëve ekselentë në administratën shtetërore dhe krijimi i fondit të solidaritetit.

### Të dhënat zyrtare, Shqipëria ka 6100 persona me grada shkencore

**N**donëse një vend me një popullsi të vogël, Shqipëria është një nga vendet me një përqindje të lartë të personave që kanë marrë grada shkencore. Në total sipas të dhënave zyrtare që janë pasqyruar edhe në Paktin për Universitetin nga viti 2007 deri në vitin 2018, në regjistrin e Ministrisë së Arsimit rezultojnë 6100 persona që kanë grada shkencore nga ajo më e ulët dhe docent e deri të grada akademike profesor. Më konkretisht, në këtë regjistrë ekzistojnë të regjistruar 248 docentë, 3757 persona me gradë shkencore doktor të marra brenda vendit dhe 546 persona të tjerë me gradën doktor të marrë jashtë vendit. Gjithashtu, gjithmonë sipas këtij regjistri ekzistojnë 1038 tituj akademikë profesor i asociuar të marrë brenda vendit dhe vetëm 2 tituj akademikë profesor i asociuar të marrë jashtë vendit. Ndërkohë që në krye të piramidës së gradave dhe titujve shkencorë qëndrojnë 503 tituj akademikë me gradën profesor. Ndërkohë që Ministria e Arsimit bën me dije se gjatë verifikimit të kriterave të ligjshëm për të gjitha universitetet në vend janë konstatuar një sërë problematikash, ku rasti më i rëndësishëm është raporti 1 profesor me 41 doktorantë. Ndërkohë në një rast është konstatuar se një titull shkencor ishte marrë brenda vetëm 3 muajve.

### Albana Vokshi: Qeveria po mashtron dhe përçan studentët

**P**artia Demokratike e ka konsideruar "Paktin për Universitetin" të prezantuar dhe nga qeveria si mashtrim dhe në shkelje të ligjit. Nga foltorja e Partisë Demokratike, deputetja, Albana Vokshi, tha se ky pakt nuk plotëson kërkesat e studentëve dhe se nëpërmjet tij kryeministri po bën përpjekje për të mashtruar dhe përçarë studentët. "Aktualisht Rama ka alokuar për arsimin, duke përfshirë të gjitha nivelet e arsimit, vetëm 313 milionë euro, ndërkohë që kërkesa e studentëve është 702 milionë euro për të arritur në nivelin 5%. Pra, duket qartë që kemi buxhet të munguar", - tha Vokshi.

drejt të marrë mësim", - iu drejtua Rama pedagogëve. Më tej, ai theksoi se qeveria s'mund të merret peng duke i bërë presione, ndaj i ftoi të gjitha palët në këtë proces të dialogojnë. "Ne nuk mund të jemi peng, as qeveria e as studentët. Peng qeverinë s'mund të merrni dot duke bërë presione, duke u fshehur, duke mos bërë mësim. Unë për veten time këtë protestë nuk e lë sikur të ngelem vetëm. Jam i gatshëm t'i mbaj të gjitha përgjegjësitë, edhe për borën që bie, por për budalla mua njeri dot nuk më bën", - tha Rama. Ministria e re e Arsimit

dhe të gjithë kolegët e saj ministra kanë prezantuar rrugët e zgjidhjes që nga tani deri tek punësimi i studentëve të diplomuar, ndërkohë që kryetari i Bashkisë së Tiranës foli mbi punën që po bëhet për rikonstruksionin e konvikteve dhe masat për të rritur forcën financiare të qendrave studentore. "Ku janë kartat e studentit? Ka 20 vite që premtotet? Pse duhet të besoj unë sot që këto do bëhen kur nuk janë bërë në 20 vite", - tha një prej studentëve të pranishëm në sallë. Këtëj skepticizmi iu përgjigj kryebashkiaku i Tiranës, i cili theksoi

se puna që po bëhet për rikonstruksionin e konvikteve është dëshmia dhe prova se qeveria dhe bashkia e kanë marrë seriozisht plotësimin e kërkesave të studentëve. "Kështu që po të jetë për provë, mos e lini protestën, pra 29 të tjerët le të fillojnë ngulimin po ti hajde, hajde me mua sot dhe e shohim. Nëse realisht aty, madje konvikti që filloi para 10 ditësh nesër mbaron. Pra, po punojmë me kohë rekord, me brigada në çdo kat dhe unë them, çoni një përfaqësues, mund të jesh ti. Vjen e sheh me mua, nëse gënjej unë", - tha Veliaj.

#### NOJFTIM SHITJE ME ANKAND

##### ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA nr. 1/258, e llojit "Truall dhe Ndërtesë" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur në Ish-Fushën e Avionit, TIRANË) me sipërfaqe të truallit 273 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërrim prej 200,2 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale 8220, Vol. 23, Fq. 28, në pronësi të Znj. DENKË SEFERI.

CMIMI 25.472.989,70 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.02.2019.

CEL: 0684026666 / 0693262666.

#### Shoqëria permbarimore JUSTITIA

Shoqëria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e TRETË, për shitjen e pasurisë së palaujtshme për të cilën ka vënë hipoteke NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:

Lloji i pasurisë Aret-Truall (magazine dy kate) me sip. arë 3000 m<sup>2</sup> /truall 1661/ndërtesë 234,9, me nr.pasurie 589 vol 8 fq78, z.1475, Derven, KRUIË në pronësi të Haki Ahmet MAVRIQI Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 60.480 (gjashtëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) EUR

Ankandi zhvillohet në datën 15.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbarsesit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

#### Shoqëria permbarimore JUSTITIA

Shoqëria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e PARË, për shitjen e pasurisë së palaujtshme për të cilën ka vënë hipoteke NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:

Nr. 1/387-N1, Zk. 8562, VOL 30, FQAQ. 91 e lloji njesi me sip. 109 m<sup>2</sup> ndodhur në adresën Rruga "Fust Batani", Korçë në pronësi të Pandëll Bonja.

Çmimi me të cilin fillon ankandi është në vlerën 57,089 EUR (pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e tashë) EUR. Ankandi zhvillohet në datën 04.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbarsesit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

## Grupi akuzohet për 3 grabitje të bujshme

### Grabitja e 3 mln eurove në Rinas, prokuroria kërkon 119 vite burg për 8 të pandehur

**TIRANË.** Pas një sërë seancash gjyqësore, Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe ka dhënë pretendencën për autorët e grabitjes së 3 milionë eurove në Rinas. Organi i akuzës ka kërkuar 119 vite burg për 8 të pandehurit, të cilët në 3 grabitje bankash, arritën të marrin rreth 8 milionë euro. Prokuroria i akuzon se kishin ngritur një grup të strukturuar kriminal, për vjedhje bankash dhe armëmbajtje pa leje. 20 vite burg u kërkuar për ish-komandon Neim Avdulaj dhe Dash Kupën, ndërsa për vëllain e tij Ernestin, u kërkuar 19 vite e 8 muaj heqje lirie. Nga 16 vite heqje lirie u kërkuar nga organi i akuzës për Fatjon

#### PRETENCA PËR 8 TË PANDEHURIT

1. Dash Kupa	20 vite burg
2. Neim Avdulaj	20 vite burg
3. Ernes Kupa	19.8 vite burg
4. Fatjon Xhyliu	16 vite burg
5. Dritan Xhinani	16 vite burg
6. Aleksandër Murataj	16 vite burg
7. Ditjon Memlika	5.8 vite burg
8. Admir Çerpja	5.8 vite burg

Xhyliu, Dritan Sinanin dhe Aleksandër Murataj. Dënimi me nga 5 vite e 8 muaj burg u kërkuar për ish-komandon tjetër, Ditjon Memlikën dhe Admir Çerpjen, pasi këta dy persona mbajnë dhe statusin e bashkëpunë-

torit të drejtësisë. Për personin, i cili krijoi grupin kriminal dhe ideoi 3 grabitje, Admir Muratajn, gjykimi është pezulluar pasi ai nuk është mundur të arrestohet. Ky grup, sipas prokurorisë është përgjegjës për të paktën 3 grabitje. Në 13 shkurt 2015, ata grabitën me armë një bankë të nivelit të dytë, pranë Stacionit të Trenit në Tiranë. Nën kërcënimin e armëve morën rreth 2 milionë euro, gjatë kohës që policia private po i nxirrte nga banka. Në 3



dhjetor 2015, ky grup grabiti blandin me para të një banke të nivelit të dytë, në rrugën e Rinasit, ku u morën rreth 3 milionë euro. Në 9 shkurt 2017, i njëjti grup akuzohet se po në rrugën e Rinasit përdorën të njëjtën skemë. I dolën para një blindi me para, duke grabitur rreth 3 milionë euro. Kjo do të

ishite grabitja e fundit e grupit, pasi në 14 shkurt policia arriti të arrestojë dy nga grabitësit dhe më pas u ndaluan edhe 6 persona të tjerë. Zbulimi i pjesëtarëve të grupit u bë kryesisht nga dëshmitë e dy bashkëpunëtorëve të drejtësisë, Ditjon Memlikës dhe Admir Çerpjes.

Para 1 viti la qelinë, autori ishte dënua me 12 vjet heqje lirie për tentativë vrasje

## Vrau 35-vjeçarit se i zuri rrugën me makinë, në kërkim Olger Mustafaj

KORÇË

Një ditë pas vrasjes me plumb në kokë të 35-vjeçarit Altin Balliu, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen që tronditi banorët e qytetit të Korçës. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se i riu që u ekzekutua në lagjen nr. 10 të qytetit juglindor është nga fshati Slatinjë i Pogradecit dhe se autori i krim-it dyshohet të jetë 34-vjeçari Olger Mustafaj. Menjëherë pas vrasjes, blutë kanë shpallur në kërkim Mustafën, person me precedent të mëparshëm penalë. Sipas hetuesve të çështjes, vrasja ndodhi pas një konfliktit në një lokal në këtë zonë. Mësohet se autori i dyshuar ishte konfliktuar me 35-vjeçarin dhe shokët e tij për bllokimin e rrugës me makinë nga këta të fundit. Pas përplasjes së ndodhur në ambientet e lokalit, autori, i cili ishte banor i lagjes, është larguar për t'u rikthyer me pistoletë në dorë. Ai dyshohet se e ka gjetur vetëm viktimit, gjatë kohës që po i drejtohej makinës ku ndodheshin shokët e tij. Po të njëjtat burime sqaruan se i dyshuari Olger Mustafaj e ka qëlluar 35-vjeçarin disa herë dhe për pasojë dy prej plumbave e kanë prekur në kokë e trup, duke i shkaktuar të riu vdekjen e menjëhershme. 35-vjeçari Altin Balliu mësohet se merrej me hapjen e puseve, së bashku me vëllezërit e tij. Aktualisht, autoritetet policore kanë shpallur në kërkim autorin e dyshuar të kësaj ngjarjeje të rëndë dhe po punon për kapjen e tij. Olger Mustafaj kishte vetëm 1 vit që ishte liruar nga burgu. Në Prill të vitit 2010-ës, ai ka tentuar tentoi të vrasë bashkëmoshatarin e tij (në atë kohë) Majkëll Hysollin. Fatmirësisht, ky i fundit shpëtoi për mrekulli edhe



Autori i krim-it, Olger Mustafaj



35-vjeçari i vrarë, Altin Balliu

#### DËNIMI

Olger Mustafaj kishte vetëm 1 vit që ishte liruar nga burgu. Në prill të vitit 2010-ës, ai ka tentuar tentoi të vrasë bashkëmoshatarin e tij (në atë kohë) Majkëll Hysollin. Fatmirësisht, ky i fundit shpëtoi për mrekulli edhe pse u qëllua me breshëri automatiku teksa lëvizte me një mjet tip "Audi" me targa të huaja. Në lidhje me këtë ngjarjeje, Mustafaj u dënua me 12 vite burg, por për sjellje të mirë ka bërë vetëm 7 vite.

pse u qëllua me breshëri automatiku teksa lëvizte me një mjet tip "Audi" me targa të huaja. Në lidhje me këtë ngjarjeje, Mustafaj u dënua me 12 vite burg, por për sjellje të mirë ka bërë vetëm 7 vite. Dënimi është ulur edhe prej gjendjes së keqe shëndetësore me 1 vit, pasi Mustafaj është operuar dy herë.

**TIRANË.** Gjykata e Tiranës ka dhënë dje masat e sigurisë për 13 personat e arrestuar, të cilët akuzohen për evazion fiskal me TVSH-në dhe që i shkaktojnë shtetit një dëm prej 18 mln euro. Ndonëse operacionin e përsëriti dhe vetë kryeministri Rama dhe Prokuroria kishte një dosje të gjatë, gjykata ka lënë në burg vetëm 3 nga 12 të tjerë që u arrestuan. Tre shtetasit e të ndaluar dhe konkretisht: Kudret Memaga, Gentjan Dedja dhe Bledar Metko do të qëndrojnë me masën e sigurisë arrest 30 ditë si persona të dyshuar pjesë e skemës të mashtimit me pasojë të rënda. Ndërsa për 9 personat e tjerë, gjykata ka vendosur masën e sigurisë "Detyrim paraqitje". Mësohet se këta të fundit

## "Shfryhet" operacioni, 3 në burg nga 12 të arrestuar

### Evazoni fiskal, 18 mln euro u grabitën nga persona të punësuar si kamerierë e lavazhierë



rezultojnë të paarsimuar, ose me pak klasë shkollë dhe me profesione të lira si kamerier, lavazhier apo punëtor krahu dhe hamall. Ata kanë

punuar para organit të akuzës së kanë qenë thjeshtë të punësuar me rroge mujore dhe kanë dhënë kartat e tyre të identitetit, që më pas janë përdorur për t'i përshirë në skemën mashtruese. Burimet nga organi i akuzës pohuan për "GSH" se shtetasit që u liruan kanë bashkëpunuar me prokurorinë duke rrëfyer emrat e personave, me të cilat organizuan skemën mashtruese, që i kushtoi buxhetit të shtetit shumën prej 18 mln euro. Të njëjtin fakt e konfirmoi edhe avokati Enea Cenko. Burime

nga institucioni i akuzës thanë se për emrat identifikuar përmes rrëfimeve nga të pënduarit janë nxjerrë urdhër ndalim. Dy ditë më parë "GSH" zbardhi dosjen e hetimit të 25 personave të akuzuar për evazion fiskal. Për të përfutur kompensimin e TVSH-së, të këputuar me prokurorinë duke rrëfyer emrat e personave, me të cilat organizuan skemën mashtruese, që i kushtoi buxhetit të shtetit shumën prej 18 mln euro. Të njëjtin fakt e konfirmoi edhe avokati Enea Cenko. Burime

#### Vrasja në Ballsh, vëllai i viktimës: Dua kujdestarinë e fëmijëve

**FIER.** Pak ditë pas vrasjes së dyfishtë që ndodhi në Ballsh, ku burri vrau me thikë gruan dhe kumatën e tij 18-vjeçare, vëllai i viktimave ka depozituar një kërkesë në gjykatë. Krimi makabër ndodhi më 2 janar, ndërsa viktimë ngelën Gentiana dhe Merisa Caushaj. Mësohet se vëllai i Gentiana Caushaj, Gjyshmir Caushaj ka kërkuar kujdestarinë e dy fëmijëve të mitur të motrës së tij. Këta të fundit aktualisht ndodhen në fshatin SOS, pasi u dërguan aty për një trajtim më të specializuar për shkak të traumës kur panë se si babai i tyre u vrau nënën dhe tezen para syve. Sipas vëllait të viktimave, Gazmend Musta nuk mund të ushtrojë kujdestarinë e dy fëmijëve. "Gazmend Musta nuk mund të ushtrojë kujdestarinë e dy fëmijëve. Ata tani ndodhen në fshatin SOS", tha daja i dy fëmijëve.

Zbardhet vendimi, kërkohej prova të reja për ish-ministrin e Brendshëm

# Tre muaj hetime të tjera për Tahirin, Krimet e Rënda, "shpresë" te Mali i Zi

## Prokurorët e çështjes: Presim përgjigjen e letërporosisë

TIRANË

Prokuroria e krimeve të Rënda ka vendosur shtyrjen me 3 muaj të tjerë të afatit të hetimit ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, i akuzuar për "Trafikim i narkotikëve", kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal dhe "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë". Afati për përfundimin e hetimeve përfundoi më 17 janar, ndërsa prokurorët e çështjes janë në kërkim të provave të reja që mund të dalin nga hetimi deri në prill. Kjo, pasi vendimmarrja në lidhje me çështjen "Tahiri" ka mbetur peng i përgjigjes së dy letërporosisë nga Italia dhe Mali i Zi. Në vendimin për shtyrjen e hetimeve, tre prokurorët Vladimir Mara, Dritan Prençi dhe Arens Çela arsyetojnë se më datë 10.12.2018 është dërguar kërkesa për ndihmë juridike Autoriteteve të Drejtësisë të Mali të Zi (në vijim të letërporosisë të tjera) dhe akoma nuk janë administruar aktet në ekzekutim të kësaj letërporosisë. Po ashtu, në vijim të kërkesave për ndihmë juridike, më datë 04.01.2019 janë administruar në mënyrë të drejtëpërdrejtë aktet në ekzekutim të letërporosisë dërguar autoriteteve italiane të Drejtësisë më datë 31.12.2018. Këto akte aktualisht po përkthehen në gjuhën shqipe. "Meqenëse afati hetimor mbaron në datë 17.01.2019 është e nevojshme zgjatja e afatit hetimor për 3 muaj, për të realizuar edhe disa veprime të tjera hetimore si: administrimi i përgjigjes së kërkesës për ndihmë juridike dërguar në Republikën e Mali të Zi, përkthimi i akteve të administruara në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga autoritetet italiane të drejtësisë, si dhe kryerja e veprimeve hetimore të tjera që mund të dalin nga dinamika e hetimit", thuhet në vendim.



Ish-ministri Saimir Tahiri

shtetasi Saimir Tahiri, lindur më 30.10.1979. Në lidhje me këtë çështje janë në hetim dhe subjekte të tjera të dyshuara si bashkëpunorë të personit në hetim Saimir Tahiri. Në lidhje me këto fakte penale dhe subjektet e tjera të dyshuara si të përfshira, Moisi Habilaj, Florian Habilaj dhe disa persona të tjerë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet të Rënda, është zhvilluar hetimi në rang të procedimeve penale me Nr.134 të vitit 2016 dhe 164 të vitit 2017. Konform nenet 79 të Kodit të Procedurës Penale më datë 18.10.2017 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet të Rënda, Tiranë ka vendosur bashkimin e procedimeve penale me Nr. 134 të vitit 2016, 164 të vitit 2017 dhe 313 të vitit 2017 në një procedim të vetëm dhe konkretisht procedimin penal me Nr. 134 të vitit 2016.

**VENDIMI I PROKURORISË**  
Në Vladimir Mara, Dritan Prençi dhe Arens Çela, Prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet të Rënda pasi studiuan aktet e procedimit penal Nr. 134 të vitit 2016, **KONSTATUAM:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet të Rënda, Tiranë me iniciativë konform nenet 287 të Kodit të Procedurës Penale ka regjistruar procedimin penal Nr. 313 të vitit 2017 për veprat penale të "Trafikimi i narkotikëve" kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 283/a/28 dhe 333/a të Kodit Penal dhe Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, vepra këto të dyshuara si të kryera nga

cedimeve rezulton të jetë shënuar emri i shtetasit Saimir Tahiri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, si person që i atribuohet veprat penale të "Trafikimi i narkotikëve" kryer në bashkëpunim në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 283/a/28 dhe 333/a të Kodit Penal dhe Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë" parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Nga ana e autoriteteve italiane të drejtësisë është arrestuar personi në hetim Moisi Habilaj dhe disa persona të tjerë si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të "Trafikimit të narkotikëve kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal".

Arrestimi i këtyre shtetasve është kryer në funksion të hetimeve që autoritetet italiane të drejtësisë po zhvillojnë në lidhje me kapjen dhe sekuestrimin e sasisë prej 3.5 tonësh lëndë narkotike e llojit kanabis sativa në territorin e shtetit italian. Konkretisht, nga autoritetet ligjzbatuese italiane, grupit kriminal me organizator shtetasin Moisi Habilaj i janë sekuestruar lëndë narkotike në katër raste.

Rasti i parë është në datë 25.10.2013 ku në vendin e quajtur "Augusta" janë sekuestruar 1650 kg lëndë narkotike kanabis sativa, rasti i dytë në datë 27.02.2014 në vendin e quajtur Palagonia ku u sekuestruan 290 kg lëndë



Faksimile e vendimit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda

narkotike kanabis sativa, rasti i tretë në datë 29.07.2014 në qytetin e Katanius ku u sekuestruan 294 lëndë narkotike kanabis sativa dhe rasti i katërt në vendin e quajtur Risposto, ku u sekuestruan 880 kg lëndë narkotike kanabis sativa dhe dy armë luftarake automatike.

Nga hetimet e kryera rezulton se i pandehuri Moisi Habilaj dhe bashkëpunorët e tij kanë bashkëpunuar me zyrat të lartë të policisë së shtetit ku si person i dyshuar është dhe ish-ministri i Brendshëm, personi në hetim Saimir Tahiri. I pandehuri Moisi Habilaj në bashkëpunim me persona të tjerë duke përfunduar nga lidhjet fisnore me ish-ministrin e Brendshëm dhe kundrejt shpërblimeve të dhëna atij, kanë arritur të bëjnë të mundur kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike dhe transportimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë vendit.

Në djepin të këtyre detajeve dhe me veprime konkrete dyshohet të jetë përfshirë ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, i cili ka siguruar paprekshmërinë e veprimtarisë kriminale të grupit kriminal me strukturat e policisë së shtetit, ku dyshohet që një pjesë e përfitimeve monetare shkonin tek ish-ministri i Brendshëm, shtetasi në hetim Saimir Tahiri.

Më datë 10.12.2018 nga ana jonë është dërguar kërkesa

për ndihmë juridike Autoriteteve të Drejtësisë të Mali të Zi (në vijim të letërporosisë të tjera) dhe akoma nuk janë administruar aktet në ekzekutim të kësaj letërporosisë.

Po ashtu, në vijim të kërkesave për ndihmë juridike, më datë 04.01.2019 janë administruar në mënyrë të drejtëpërdrejtë aktet në ekzekutim të letërporosisë dërguar Autoriteteve italiane të Drejtësisë më datë 31.12.2018. Këto akte aktualisht po përkthehen në gjuhën shqipe.

Meqenëse afati hetimor mbaron në datë 17.01.2019 është e nevojshme zgjatja e afatit hetimor për 3 (tre) muaj, për të realizuar edhe disa veprime të tjera hetimore si: Administrimi i përgjigjes së kërkesës për ndihmë juridike dërguar në Republikën e Mali të Zi, përkthimi i akteve të administruara në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga Autoritetet Italiane të Drejtësisë, si dhe kryerja e veprimeve hetimore të tjera që mund të dalin nga dinamika e hetimit.

**VENDOSËM:** Zgjatjen e afatit të hetimeve në procedimin penal Nr.134 të vitit 2016 në ngarkim të personit në hetim, shtetasit Saimir Tahiri, për 3 (muaj), nga data 17.01.2019-17.04.2019. Të njoftojmë me këtë vendim shtetasin Saimir Tahiri dhe mbrojtësit e tij, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga njoftimi.



Mashtrimi me rimbursimet e ilaçeve, ndalohej dy farmacistët

**TIRANË** - Dy farmacistë kanë përfunduar në prangat policisë së Tiranës, si të përfshirë në skemën e mashtrimit të rimbursimit. Bëhet fjalë për shtetasit Petrit Nezir Skura dhe Gazmend Pajtim Aliaj, ndaj të cilëve rëndojnë akuzat e "Mashtrimit kompjuterik" dhe "Mashtrimit në subvencione". Ata u ndaluan me urdhër të prokurorit Ervin Karanxha. Mësohet se prokuroria e kryeqytetit, më datë 12.06.2018 ka regjistruar procedimin penal nr. 4628 që bën fjalë për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës". Ngjarja ka të bëjë me dyshimin e kryetarit të farmacistëve në vlerën e rimbursimit të madh për vitet e fundit, siç janë Bioplus, Medigreen dhe Geni & Lori, nëpërmjet mashtrimit kanë përfituar fonde dhe subvencione nga shteti, duke përfituar nga fakti se kanë kontratë me FSDKSH-në, për rimbursimin e ilaçeve që ata shesin. Sipas policisë, ekzistojnë shkaqe të bazuara për të menduar se ka rreziq largimi për shtetasin Petrit Nezir Skura, duke bërë të domosdoshëm urdhërimin e ndalimit të këtij personi. Në lidhje me "trezikum e largimit", Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (Vendim Unikifues Nr.7, datë 14.10.2011) janë shprehur se: "Ky rreziq, krahas elementeve të tjerë, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj. Prej tyre mund të arrihet në përfundim logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për ta izoluar në pandehurin". Për të njëjtat argumente është urdhëruar dhe ndalimi i farmacistit Gazmend Pajtim Aliaj nga Delvina.

**Njoftim për shitje me ankaud te II**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë të pasurisë të palës dëbore Shqipëria "GI P R A" sh.p.k. e përbërë nga:

- "ARE" Nr. pasurie 31/3, në Z.K.Nr. 225, volum nr. 5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m2, në Kohas, Durres. Ankandit i II fillon me çmim fillestar në masën 114.532 Euro.
- "ARE", Nr. pasurie 314, në Z.K.Nr. 225, volum nr. 1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12.900 m2, në Kohas, Durres. Ankandit i II fillon me çmim fillestar në masën 210.073,92 Euro.
- "ARE" Nr. pasurie 312, Z.K.Nr. 225, volum nr. 1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4.300 m2, në Kohas, Durres. Ankandit i II fillon me çmim fillestar në masën 70.024, 64 Euro.

Ankandit do të zhvillohet në datë 4.02.2019 ora 15:00 në selinë "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyrë nr.5 Kontakt tel. 06728243, IIR: derwishaj@yahoo.com. WEB: www.powerjustice.al.com.

**Njoftim për shitje me ankaud te dyte**

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenet 568, 577, e vijues te K.P.C shpall ankandin e dytë për pasurinë e palës dëbore Sh "Strati Construcon" sh.p.k. Pasuria përbëhet nga:

- "Ate" Nr. pasurie 17223 ndodhur në Durrës dhe Durres, Z.K.Nr. 1522, volum 3, faqe 249, me sipërfaqe totale 1.000 m2. Ankandit fillon me çmim fillestar në masën 2.240.000 lekë.
- "Apartment" Nr. pasurie 116/61-1-19 në Kryemadhe Kavajë, Z.K.Nr. 2291, volum 23, faqe 42, sipë 32.19 m2, Ankandit fillon me çmim fillestar në masën 1.064.000 lekë.
- "Apartment" Nr. pasurie 116/61-1-20 në Kryemadhe Kavajë, Z.K.Nr. 2291, volum 23, faqe 43, sipë 59.24 m2 dhe Ankandit fillon me çmim fillestar në masën 1.904.000 lekë.

Ankandit qendron hapur 30 ditë dhe do të zhvillohet në datë 4.02.2019 në orën 15:00 në Bulvardin "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyrë nr. 5, Tiranë. Kontakt tel. 00355 67 20 82 543 e-mail: IIR: derwishaj@yahoo.com e WEB: www.powerjustice-al.com.

Organizatat kërkojnë tërheqjen e ekzekutivit nga dy projektligjet që censurojnë fjalën e lirë

# Mediat online, gazetarët kundër qeverisë

*"Nismat, rrezik për lirinë e shprehjes dhe demokracinë në vend"*

Ivana Dervishi

Shtatë organizata që vepron në fushën e medias apo në mbrojtje të drejtave të njeriut dolën të premtën me një deklaratë të përbashkët, ku i përsëritën kryeministrit Edi Rama thirrjen për tërheqjen e dy projektligjeve për median online.

Deklarata e përbashkët e BIRN Albania, Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë, Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë, AIS/Open Data Albania, Civil Rights Defenders, Këshilli Shqiptar i Medias dhe Qendra Shqiptare MediaLook thekson se projektligjet cenojnë demokracinë në vend dhe lirinë e medias.

"Këto dy projektligje rrezikojnë ta kthejnë Shqipërinë në një vend jodemokratik, cenojnë rëndë lirinë e shprehjes dhe nuk zgjidhin asnjë nga problematikat ekzistuese të medias, përfshirë gjuhën e urrejtjes, shpifjen, propagandën apo dezinformimin," vërejtën organizatat firmëtare.

Në dhjetor 2018, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë propozuan ndryshimin e ligjit funksional të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, AKEP si dhe Autoritetit të Medias Audiovizuale (AMA) me synimin e krijimit të një regjistri të çdo faqeje në internet dhe dhënies së të drejtës të një institucioni të quajtur "Këshilli i Ankesave" për gjobitje të mediave në bazë të kërkesave të të tretëve, ose të urdhërojë mbylljen e mediave, ose të aksesit në faqe interneti në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Projektligjet për "Disa ndryshime dhe shtesa në



ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" dhe "Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9918 Datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar - u japin të drejtë AMA-s ose Tatimeve të gjobisin dhe mbyllin median online, pa një procedurë të mirëfilltë ligjore, duke rritur rrezikshëm nivelin e censurës e vetëcensurës ekzistuese në median shqiptare.

Vepimet në kuadër të të ashtuquajturës "paketë anti-shpifje" të qeverisë Rama u kritikuan në tetor nga përfaqësuesi i OSBE për Lirinë e Medias, Harlem Désir, që i cilësoi ato si me

pasojë negative për lirinë e medias.

Edhe katër organizata ndërkombëtare të lirisë së medias, Federata Europiane e Gazetarëve, Qendra Europiane për Liri të Medias dhe të Shtypit, PEN International dhe Reporterët pa Kufi, i dërguan një letër publike kryeministrit Edi Rama në dhjetor duke i kërkuar të tërheqë projektligjet.

Seancat dëgjimore për projektligjet, ku organizatat e gazetarëve dhe ato të të drejtave të njeriut në Shqipëri kanë marrë pjesë, u shoqëruan me përsëritjen e thirrjes së këtyre të fundit për autoritetet që të tërheqin projektligjet.

"Nëse maxhoranca socialiste do të miratojë këto

dy projektligje, demokracia jonë hibride do rrëshqasë drejt modelit të një regjimi autoritaritar," u shprehën

## CFARE JANE 2 NIMSAT E QEVERISE

Dy projektligjet u japin të drejtë AMA-s ose Tatimeve të gjobisin dhe mbyllin median online, pa një procedurë të mirëfilltë ligjore, duke rritur rrezikshëm nivelin e censurës e vetëcensurës ekzistuese në median shqiptare.

organizatat në deklaratën e tyre. "Kjo, pasi në vendet demokratike, ligjet synojnë të mbrojnë qytetarët nga

qeveria dhe jo qeverinë nga qytetarët," shtuan ato.

Shtatë organizatat hodhën, gjithashtu, poshtë pretendimin e AMA-s dhe zyrtarëve të qeverisë, përfshirë kryeministrit Rama se projektligjet në fjalë mbështeten në "modelin kroat".

"Nga verifikimet tona, në Kroaci nuk ekziston asnjë legjislacion i ngjashëm për mbikëqyrjen, gjobitjen dhe mbylljen e medias në internet", vërejtën ato.

Media online është vënë, gjithashtu, në një targetim të posaçëm, vërejtur kjo edhe nga tatimi në masën 20% që i bën ligji për TVSH medias online, tarifë kjo që për median vizive është ulur në 6%.

Organizatat bënë thirrje për korrigjim të tatimit për median online, si dhe nxitën qeverinë të shohë vetërregullimin e medias dhe edukimin e publikut përmes fushatave për rritjen e njohurive mbi median, propagandën, dizinformimin apo lajmet e rreme si mjetet e duhura për të luftuar problemet në komunikimin online dhe jashtë rrjetit.

"Duke marrë parasysh detyrimet e Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit me Bashkimin Europian, ne vërejmë se të dy projektligjet propozuara përbëjnë hap pas në procesin e integritetit", përfunduan shtatë organizatat deklaratën e tyre.

## Invitation to Quote (ITQ)

Albania

World Bank Loan/Credit Name: Citizen Centric Service Delivery Project; 8521-AL

"Goods-IT equipment for ADISA (tablets for institutions live citizen mechanism)"

Ref: AL-8521/G/SH/2.02.04

1. The Government of Albania has received a loan from the International Bank for Reconstruction and Development towards the cost of Citizen Centric Service Delivery Project and intends to apply part of the funds to cover eligible payments under the Contract for "Tablets for institutions live citizen mechanism"; Ref: AL-8521/G/SH/2.02.04.

The purpose is to purchase 100 tablets that will be installed and mounted on the wall by the economic operator, in the context of receiving citizen feedback for public services provided by public institutions.

2. The Agency for Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA) invites to quote with regard to the items under this Invitation. Price quotations will be evaluated for all the items together and contract will be awarded to the firm offering the lowest evaluated total cost of the items. The prices should be quoted in ALL (Albanian Lek) for the Total Cost which includes all taxes, VAT, customs, duties, inland transportation and insurance, loading and unloading.

3. The full Invitation to quote document including Technical Specification may be found to ADISA website ([www.adisa.gov.al](http://www.adisa.gov.al)) or requested at the emails below by interested suppliers. Quotation may be submitted by official mail, or electronically at the following address:

ADISA

Bldv: Zhan d'Ark,

Ish shtepia e oficerave, Kati V-te

Tirana, Albania

e-mail: [roland.larashi@adisa.gov.al](mailto:roland.larashi@adisa.gov.al);

and also [fiorentina.jorgji@adisa.gov.al](mailto:fiorentina.jorgji@adisa.gov.al); [informacion@adisa.gov.al](mailto:informacion@adisa.gov.al)

Interested suppliers may obtain further information at the same addresses.

4. The deadline for submission of Quotation is January 31 2019, 12:00 local time.



Novartis Pharma Services Inc. Tirana-Albania, the Representative Office of the multi-national company, NOVARTIS, the worldwide leader in the pharmaceutical industry, wants to hire a **Product Specialist**.

### Job Purpose:

To develop, implement and execute marketing mix and tactical plans for a brand or set of brands in the short and long term.

### Some of his/her qualifications and requirements would be:

- University degree in Medicine, Pharmacy, Biology, Chemistry or other relevant University education.
- At least 5 years of experience in pharma industry (in marketing, sales or medical)
- In-depth understanding of marketing, preferably of pharma marketing
- Ability to build excellent relationship with all key stakeholders with high customer centric mindset
- Ability to generate new ideas/projects customized to the local pharma market
- Ability to manage multiple projects and priorities in a high-volume, fast-paced environment
- Marketing and negotiating skills
- Good communications skills
- Digital literacy and comfortable with technology
- Good command of spoken and written English
- Excellence in implementing planned activities and marketing campaigns adhering to the relevant Codes of Practice/regulations.

The interested candidates are invited to send the CV as well as a Motivational Letter at the e-mail address: [blerta.rambi@novartis.com](mailto:blerta.rambi@novartis.com)  
Deadline 31 January 2018  
We will contact only the selected candidates





"Përfitojnë pacientët me sëmundje, trajtimi i të cilave është i rimbursuar"

## Ndryshime në listën e barnave me rimbursim, kategoritë përfituese

*FSDKSH: Kush mund të dërgojë propozimet, afati i fundit*

Voltiza Duro

**B**renda vitit 2019-të, pritet të ketë disa ndryshime në listën e barnave të rimbursuara. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ka bërë me dije se afati i dorëzimit të propozimeve për ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara është deri në 15 janar të këtij viti. "Afati i dorëzimit të propozimeve për ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara është deri më datë 15.01.2019, ora 16:30. Pas kësaj date propozimet nuk do të pranohen. Propozimet për ndryshime në LBR duhet të dërgohen nëpërmjet shërbimit postar. Dorëzimi i propozimeve do të bëhet pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në adresën, Rruga "Sami Frashëri", Nr. 8, Tiranë, nëpërmjet protokollimit në zarf të mbyllur, drejtuar "Komisionit Teknik të Listës së Barnave të Rimbursuara". Materiali shkencor plotësues që shoqëron kërkesën mund të jetë bashkëlidhur, edhe në formë elektronike (CD)", thekson FSDKSH.

**PROPOZIMET**  
FSDKSH bën me dije se do të pranohen të gjitha propozimet e dërguara nga: Shoqatat e mjekëve, Shoqatat e farmacistëve, Firmave farmaceutike prodhuese, Përfaqësitë e firmave prodhuese, Shërbimi shëndetësor parësor, Klinikat e QSU "Nënë Tereza". Komisioni i Nomenklaturës së Barnave Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

### PROPOZIMET DHE DOKUMENTACIONI

**Do të pranohen të gjitha propozimet e dërguara nga:**

Shoqatat e mjekëve,  
Shoqatat e farmacistëve,  
Firmave farmaceutike prodhuese,  
Përfaqësitë e firmave prodhuese,  
Shërbimi shëndetësor parësor,  
Klinikat e QSU "Nënë Tereza".  
Komisioni i Nomenklaturës së Barnave  
Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

**Për propozimet e klasës A1, A2, A3 duhet:**

Evidenca përkatëse shkencore (për shembull, fotokopje të artikujve të literaturës aktuale, shqiptare ose botërore, konkluzione të forumeve shkencore vendase apo çdo e dhënë tjetër mbi të cilat mbështetet propozimi).

**Për propozimet e klasës A4 duhen:**

Të dhëna lidhur me efikasitetin e barit të propozuar, krahasuar me efikasitetin e barnave ekzistues në Listën e Barnave të Rimbursuara (për shembull, fotokopje të artikujve të literaturës aktuale, shqiptare ose konkluzione të forumeve shkencore vendase apo çdo e dhënë tjetër).

Të dhëna mbi profilin e efekteve anësore të barit të propozuar, i krahasuar me atë të barnave ekzistuese në Listën e Barnave të Rimbursuara (për shembull, fotokopje të artikujve të literaturës aktuale, shqiptare ose konkluzione të forumeve shkencore vendase apo çdo e dhënë tjetër).

Krahasimi i kostove të mjekimit me barin e propozuar dhe barnat ekzistuese në Listën e Barnave të Rimbursuara. Për propozimet e klasës B1 dhe B2 duhen:

Frekuenca/incidenca e sëmundjes mundësisht në vendin tonë.

Roli dhe specifika terapeutike të barit që propozohet në trajtimin e sëmundjes.

Të dhëna lidhur me formdozën, rrugën e administrimit, dozën ditore, kriteret e fillimit ose të mbarimit të mjekimit.

Kriteret që tregojnë realizimin e efektit të pritur. Të dhëna mbi profilin e efekteve anësore të barit të propozuar.

Kosto e mjekimit



### KATEGORITË

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor thekson se propozimet për ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara mund të jenë të dy kategorive: ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara për sëmundje, trajtimi i të cilave është i rimbursuar. Dhe ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara për sëmundje, trajtimi i të cilave rimbursohet pjesërisht ose nuk rimbursohet.

### NDRYSHIMET

Ndryshimet në Listën e Barnave që Rimbursohen për sëmundje trajtimi i të cilave rimbursohet pjesërisht ose nuk rimbursohet, mund të konsistojnë në: përdorimi i një bari të Listës së Barnave që Rimbursohen për indikacione që nuk lejohen nga kriteret e Listës së Barnave që Rimbursohen; përfshirja e një bari në Listën e Barnave që Rimbursohen për trajtimin specifik të sëmundjes.

i të cilave rimbursohet pjesërisht ose nuk rimbursohet. "Ndryshimet në Listën e Barnave të Rimbursuara për sëmundje, trajtimi i të cilave është i rimbursuar, mund të konsistojnë në: Ndryshime të kriterëve të Listës së Barnave që Rimbursohen; Ndryshime të dozave apo protokolleve të përdorimit të një bari të Listës së Barnave që Rimbursohen; Shtimi i një alternative tjetër brenda grupit Kimiko-farmakologjik ose terapeutik.", nënvizon FSDKSH. Më tej kjo e fundit bën me dije se alternativa brenda grupit Kimiko-farmakologjik nënkupton një bar që nuk është në Listën e Barnave që Rimbursohen, që nga struktura kimike dhe/ose vetitë farmakologjike ngjason dhe ka të njëjtin indikacion me një bar të Listës së Barnave që Rimbursohen. "Për shem-

"Afati i dorëzimit të propozimeve për ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara është deri më datë 15.01.2019, ora 16:30. Pas kësaj date propozimet nuk do të pranohen. Propozimet për ndryshime në LBR duhet të dërgohen nëpërmjet shërbimit postar", - thekson FSDKSH.

bull, bari Lisinopril është alternativë e barit Captopril dhe Enalapril. Alternativë

brenda grupit terapeutik. Ky term nënkupton një bar, që nuk është në Listën e Barnave që Rimbursohen dhe përdoret për të njëjtin indikacion që përdoret edhe një bar i Listës së Barnave që Rimbursohen. Për shembull: bari Chlorphenamine është alternativë e barit Cetirizine (trajtimi i rinitit alergjik)", shton më tej Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Ndryshimet në Listën e Barnave që Rimbursohen për sëmundje trajtimi i të cilave rimbursohet pjesërisht ose nuk rimbursohet, mund të konsistojnë në: përdorimi i një bari të Listës së Barnave që Rimbursohen për indikacione që nuk lejohen nga kriteret e Listës së Barnave që Rimbursohen; përfshirja e një bari në Listën e Barnave që Rimbursohen për trajtimin specifik të sëmundjes. Për këtë qëllim propozimi duhet të klasifikohet në një nga klasat e mësipërme, d.m.th: A1, A2, A3, A4, B1 ose B2.

Prokuroria: Në vitet 2003-2004 trafikoi nga Shqipëria në Itali 488 kg drogë

# Operacioni "Volvo 4", arrestohet "koka" e grupit kriminal të Shijakut, Hekuran Hoxha

## 48-vjeçari nga Xhafzotaj me nofkën "Roni" mbushi Italinë dhe Turqinë me heroinë

DURRES

Një 48-vjeçar, i cili dyshohet të jetë "truri" i grupit kriminal të Shijakut ka përfunduar në pranga, në kuadër të operacionit të koduar "Volvo 4". Operacion ky që startoi më 21 tetor të vitit që shkoi, ku FNSH dhe RENEA arrestuan mbi 20 anëtarë të bandës, mes të cilëve edhe Avdylyajt. Bëhet fjalë për Hekuran Hoxhën nga Xhafzotaj, i cili akuzohet për disa vepra penale, mes tyre pjesëmarrje në grup kriminal, trafik droge dhe pastrim parash. 48-vjeçari, i cili ndryshe njihet si "Roni i Shijakut", ideoi, në bashkëpunim me biznesmenin Admir Hoxha që është ende në kërkim ngritjen e laboratorit të heroinës në Has që u zbulua në tetor të vitit që shkoi. Ndërkaq, burime zyrtare nga policia mbremë bënë me dije se shtetasi në fjalë u kap, pasi më 17 janar të këtij viti, prokuroria ka lëshuar urdhër ndalimi ndaj tij. Ai dyshohet për kryerjen e veprave penale: "Prodhim dhe shitje e narkotikëve"; "Trafikim i narkotikëve"; "Prodhim dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal"; "Grup i strukturuar kriminal"; "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale".



Ligjit - MEGA OPERACIONI "VOLVO 4", për goditjen me vje të grupave kriminale



Laboratori i drogës në Has

**HETIMI**

Një hetim i Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe antimafigas italiane ka zbuluar se Hekuran Hoxha, në bashkëpunim me persona të tjerë, kanë mundur që gjatë viteve 2003-2004 të trafikonin nga Shqipëria në Itali 488 kg heroinë. Mes personave të këtij grupi ka qenë edhe Alket Hatija. Përveç Italisë, grupi është akuzuar për trafik dogrash të forta në Itali dhe në Turqi.

**AKUZAT**

Burime zyrtare nga policia bënë me dije se shtetasi në fjalë u kap, pasi më 17 janar të këtij viti, prokuroria ka lëshuar urdhër ndalimi ndaj tij. Ai dyshohet për kryerjen e veprave penale: "Prodhim dhe shitje e narkotikëve"; "Trafikim i narkotikëve"; "Prodhim dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal"; "Grup i strukturuar kriminal"; "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale".

kg heroinë. Mes personave të këtij grupi ka qenë edhe Alket Hatija. Përveç Italisë, grupi është akuzuar për trafik dogrash të forta në Itali dhe në Turqi. **LIDHJA ME TURQINË**  
Gazeta turke "Hyrriet" shkruante në vitin 2011 se

Abduselam Turgut ka pasur lidhje me një grup shqiptarësh të arrestuar në Durrës për sasi të mëdha heroine. Sipas medias turke, personat që kanë pasur lidhje me turkun kanë qenë Hekuran Hoxha dhe Xhemaim Posmaçiu. Në Turqi

mësohet se këta shtetas, në bashkëpunim me Abduselam Turgut, ishin akuzuar për trafikimin e një sasive prej 30.5 kilogramësh heroine të pastër: Prokurori turk i çështjes ka pohuar se Abduselam Turgut ka pasur një marrëveshje me shteta-

sit shqiptarë për trafikimin e ngarkesës së drogës nëpërmjet Shqipërisë në Europën Perëndimore. Nga ana tjetër, shtetasit shqiptarë që përmenden në median turke si të lidhur me "peshkun e madh" të narkotrafikut, kanë dosje penale edhe në Shqipëri. Më 10 shtator 2010, Prokuroria e Krimeve të Rënda arrestoi pesë persona të akuzuar për trafik ndërkombëtar narkotikësh. Aksioni u zhvillua në qytetin e Shijakut, ku ranë në pranga shtetasit Hekuran Hoxha, 38 vjeç nga Shijaku, i cili njihet me pseudonimin "Roni"; vëllai i tij, Fatbardh

Hoxha, 37 vjeç; Alket Hatija, 35 vjeç, me origjinë nga Beratit dhe banues në Shijak; Saimir Gjepali, 34 vjeç, nga qyteti i Shijakut, si dhe Mentor Shehu nga fshati Pobrat i Beratit, i cili njihet me pseudonimin "Toku". Në këtë dosje u mor një masë sigurimi edhe për shtetasin Lutfi Shabani, i njohur si "Ben Çami". Sipas hetimeve të prokurorisë, gjatë viteve 2003-2004 policia italiane ka kapur dhe sekuestruar në brigjet Apenine rreth 450 kilogramë heroinë, origjina e së cilës ishte nga Shqipëria dhe konkretisht nga Durrësi, ku ishte nisur nga të arrestuarit.

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)  
**GAZETA SHQIPTARE**

**Gazeta e gjithë shqiptarëve!**

Facebook: Gazeta Shqiptare  
 Instagram: gazetashqiptare.al  
 Twitter: Gazeta Shqiptare  
 E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com  
 Youtube: Gazeta Shqiptare

Kontakt: +355 68 40 63 842

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

## NËNSHTETËSIA GREKE APLIKIMI

Voltiza Duro

Emigrantët shqiptarë që kanë vite që punojnë edhe jetojnë në Greqi mund të përfitojnë nënshtetësinë greke. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot kategoritë e individëve që kanë të drejtë aplikimi si dhe ata që nuk mund të marrin nënshtetësi. Përkatësisht personat që nuk kanë leje qëndrimi ose kanë një leje qëndrimi të përkohshme nuk kanë të drejtë të aplikojnë për nënshtetësi helene. Gjithashtu, iu humb e drejta e aplikimit për këtë të fundit edhe individëve që kanë marrë dënime me burg që janë më shumë se 6 muaj, për lloje të caktuara krimesh, ose dënime që janë më shumë se 1 vit për krimet që janë kryer me dashje.

### APLIKIMI

Ndërkohë mund të aplikojnë për nënshtetësinë greke personat që kanë mbi 7 vite qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi si dhe ata që kanë mbi 3 vjet qëndrim të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi me kusht që të jenë martuar me një nënshtetas/e grek/e dhe të kenë fëmijë me të. Edhe individët që kanë më shumë se 3 vite qëndrim të përhershëm dhe të ligjshëm nëse kanë një fëmijë në moshë të mitur që ka nënshtetësi greke mund të marrin nënshtetësi. Përjashtohen nga aplikimi ata që e kanë fituar nënshtetësinë, sepse kanë frekuentuar një shkollë greke. Për nënshtetësinë helene mund të aplikojnë edhe refugjatët apo personat që janë pranuar si individë pa nënshtetësi nga autoritetet greke, me kusht që të kenë mbi 3 vite qëndrim të përhershëm në këtë shtet.

### DOKUMENTACIONI

Kandidatët e interesuar për të marrë nënshtetësinë greke duhet të dorëzojnë një "deklaratë natyralizimi" pranë bashkisë së vendbanimit të tyre; një aplikim për natyralizim si dhe një leje qëndrimi. Respektivisht kjo e fundit mund të jetë: leje qëndrimi afatgjatë ose leje qëndrimi e brezit të dytë; leje për bashkëshortët/et e nënshtetasve grekë ose të BE-së, ose një prind i një nënshtetasi grek në moshë të mitur; leje për një refugjat politik ose me mbrojtje të përkohshme; si dhe leje qëndrimi e dhënë si person pa nënshtetësi. Gjithashtu, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe pasaportën e tyre. Nëse individit ka lindur jashtë vendit nevojitet një certifikatë lindjeje, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht, ndërsa nëse ka lindur në Greqi, i duhet të paraqesë një certifikatë lindjeje greke.

Skualifikohen personat me leje qëndrimi të përkohshme dhe ata që janë në burg

# Emigrantët në Greqi, kategoritë që mund të aplikojnë për nënshtetësinë helene

*Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët*



Është e domosdoshme që aplikantët të dorëzojnë edhe auditimet e taksave personale për vitet e fundit, numrin e sigurimeve shoqërore (???) si dhe dokumente të tjera që vërtetojnë lidhjet e mia me Greqinë dhe grekët. Emigrantët shqiptarë në Greqi mund të bëjnë aplikimin për nënshtetësinë greke pranë Drejtorisë së Gjendjes Civile të Administratës së Decentralizuar të zonës ku jetojnë.

### TARIFAT

Të interesuarit për nënshtetësinë greke duhet të paguajnë 700 euro për aplikimin për herë të parë dhe 200 euro për aplikimin për herë të dytë dhe për të gjitha aplikimet vijuese. Ndërkohë personat e deklaruar si refugjatë apo pa nënshtetësi do të paguajnë vetëm 100 euro për aplikimin për herë të parë dhe për të gjitha aplikimet vijuese. Në projektligjin e ri që është paraqitur në parlament taksa prej 700 eurosh, parashikohet të ulet dhe të bëhet 550 euro. Pas aplikimit, kandidatët duhet të presin rreth 1 vit për të marrë përgjigje nëse aplikimi i tyre është pranuar apo jo.

### KONTROLLI ONLINE

Gjithë personat që kanë aplikuar për nënshtetësinë greke dhe duan të pyesin se

në çfazë ndodhet aplikimi i tyre, tashmë mund të telefonojnë direkt në drejtorinë e nënshtetësisë të Ministrisë së Brendshme. Të interesuarit mund të telefonojnë nga e hëna në të premte (me përjashtim të pushimeve zyrtare), dhe nga ora 10:00 deri në orën 13:00, në numrin e telefonit: (+30) 2131361919. Po ashtu ka dhe një mundësi tjetër. Të interesuarit mund të klikojnë në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme greke, ku në fund djalhtas te kutia rozë, me emrin "POREIA KTISIS ITHAJENIAS - Ecuria e marrjes së nënshtetësisë) dhe të ndjekin udhëzimet. Fillimisht ata duhet të klikojnë shërbimin ku e kanë dorëzuar aplikimin në bazë të qarkut, më tej numrin e dosjes, emrin dhe mbiemrin e tyre si dhe të shkruajnë simbolin e verifikimit në fund fare e pastaj shtypin "ANAZITISI".

### MARRJA E NËNSHTETËSISË

Prej disa kohësh, Greqia ka lehtësuar procedurat për të gjithë emigrantët shqiptarë që marrin nënshtetësinë greke. Tashmë procedura për kryerjen e shkëputjes nga leja e qëndrimit, mund të kryhet automatikisht. Në momentin që një emigrant shqiptar merr nën-

shtetësinë greke, kjo paraqitet në gazetën qeveritare. Para funksiononte në këtë mënyrë: emigranti duhet të shkente në Qendrën e Emigracionit ku dhe kishte marrë lejen e qëndrimit, dhe bënte shkëputjen nga kjo leje në mënyrë që të merrte nënshtetësinë. Por kjo ishte një procedurë që zgjaste 2-3 javë. Tashmë procedura është lehtësuar dhe bëhet automatikisht. Megjithatë heqja e lejes së qëndrimit mund të duket një veprim i thjeshtë, në fakt, njerëzve u kushtonte shumë, sidomos të rinjëve të brezit të dytë që mund të kishin shans për të shfrytëzuar programe studimi jashtë shtetit, dhe nuk pajiseshin në kohën e duhur me këtë dokumente greke. Kjo sepse nuk mund të paraqiteshin direkt në zyrat e shtetasve të huaj dhe emigracionit, por duhej që më parë të linin një takim, e cili mund të realizohej edhe pas disa muajsh.

Ndërkaq edhe mbajtësit e "kartës së homogjenit", duhej të paraqiteshin në polici për të anuluar kartën e tyre. Pra, gjithë kjo procedurë sillte një zvarritje të pa-nevojshme, në një kohë që gjithçka mund të zgjidhej në mënyrë elektronike nga shërbimet administrative greke.

### KATEGORITË APLIKUESE PËR NËNSHTETËSI GREKE

#### Kur mund të kryhet aplikimi:

Pas 7 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi.

Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi me kusht që të jenë martuar me një nënshtetas/e grek/e dhe të kenë fëmijë me të.

Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm nëse kam një fëmijë në moshë të mitur që ka nënshtetësi greke (nuk aplikohet për ata që e kanë fituar nënshtetësinë sepse kanë frekuentuar një shkollë greke).

Pas 3 viteve qëndrimi të përhershëm dhe të ligjshëm në Greqi, nëse jam refugjat ose jam pranuar si person pa nënshtetësi nga autoritetet greke.

#### Dokumentacioni

Një "deklaratë natyralizimi" pranë bashkisë së vendbanimit.

Një aplikim për natyralizim.

#### Një leje qëndrimi e llojeve të mëposhtme si:

Leje qëndrimi afatgjatë ose leje qëndrimi e brezit të dytë,

për bashkëshortët/et e nënshtetasve grekë ose të BE-së, ose një prind i një nënshtetasi grek në moshë të mitur,

një refugjat politik ose me mbrojtje të

përkohshme,

si person pa nënshtetësi

Pasaporta.

\*Nëse keni lindur jashtë vendit, një certifikatë lindjeje, e vërtetuar dhe e përkthyer në greqisht/ Nëse keni lindur në Greqi, një certifikatë lindjeje greke.

Auditimet e taksave personale për vitet e fundit.

Numri i sigurimeve shoqërore (???)

Dokumente të tjera që vërtetojnë lidhjet e mia me Greqinë dhe grekët.

#### -Kush nuk ka të drejtë aplikimi

Ata që nuk kanë leje qëndrimi ose kanë vetëm leje të përkohshme.

Ata që kanë marrë dënime me burg që janë më shumë se 6 muaj, për lloje të caktuara krimesh, ose dënime që janë më shumë se 1 vit për krimet që janë kryer me dashje.

## GRAFIKAT

Nga Ylli Drishti

# ANASTAS KOSTANDINI

## Cikli i madh grafik kushtuar Skënderbeut

Në kujtim të 551-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut, po i ofrojmë publikut një grup grafikash të gdhendura në dru (ksilografji) të realizuara nga mjeshtri i madh i grafikës shqiptare Anastas Kostandini - Taso.

Historia e këtij cikli grafikash fillon në vitin 1989 (30 vjet më parë) kur artisti Taso gdhendi në dru 5 punimet e para kur shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë po botonte "Historinë e Skënderbeut" të Naim Frashërit. Këto grafika titulloheshin: "Dyluftim në Edrene", "Shfaqja në emër e babait të Skënderbeut", "Skënderbeu dhe flamuri", "Këngë kushtuar Skënderbeut" dhe "Kështjella e pamposhtur". Cikli grafik kushtuar Skënderbeut me një kohëzgjatje 30-vjeçare numëron 24 fletë dhe ndoshta është cikli më i plotë kushtuar kësaj teme dhe i vetmi i realizuar në këto përmasa nga artistët shqiptarë. Më imazhin e heroit Skënderbe, përveç artistëve evropianë të shekujve XVI - XIX, u morën pothuajse të gjithë piktorët dhe skulptorët shqiptarë, duke filluar me tri portrete të Skënderbeut të realizuara nga Kol Idromeno në fundin e shekullit XIX, me betejat e tij të trajtuara nga piktorët Vangjel Zengo, Zef Kolombi, Simon Rrota, busti i Skënderbeut i vendosur në qytetin e Kukësit (1939) dhe tablotë e veprat skulpturore (buste dhe monumente) pas Luftës së Dytë Botërore si në Shqipëri, por edhe në Evropë dhe SHBA. Cikli grafik i mjeshtrit Kostandini në të 24 fletët e tij ka një vlerë të veçantë në historinë e artit pamor shqiptar dhe veçanërisht në historinë e grafikës bashkëkohore. Cikli është thellësisht realist, i largohet narracionit ilustrativ dhe reflekton një kulturë artistike elitare dhe një mjeshtri që ndoshta është unikale në vendin tonë. Artisti Taso ka një lidhje të gjatë me figurën e heroit Skënderbe, pasi që në moshën 15-vjeçare ai ka realizuar një tablo kompozicionale me imazhin e tij në betejë. Kjo lidhje ka bërë që artisti ta trajtojë figurën e tij gjatë viteve të krijimit të disa punime. Realizimi i grafikave duke u bazuar në veprën e Fan S. Nolit dhe Naim Frashërit i ka dhënë mundësi mjeshtrit Taso të realizojë kompozime shumëfigurëshe vertikale, që shpesh marrin formën e tablove monumentale të ndërë në breza horizontale apo dhe të tablove figurative dekorative të inspiruara nga ikonat bizantine, ku humbet perspektiva dhe merr përparësi subjekti kryesorë - imazhi i tij, ndërsa figurat e tjera shoqëruar janë në dimensione dhe raporte kompozicionale të ekuilibruara. Secila nga këto fletë grafike mund të admirohet dhe "shijohet" si veper e veçantë, e plotë dhe me cilësi të lartë artistike. Është e vështirë të gjendet sot në Shqipëri një mjeshtri i grafikës shqiptare si mjeshtri i madh Anastas Kostandini - Taso.

Cikli në fjalë kushtuar Skënderbeut ka filluar në vitin 1988 si një kërkesë e shtëpisë botuese "Naim Frashëri" të asaj kohe për të sho-



qëruar botimin e veprës së plotë të Naim Frashërit, brenda të cilës do qëndronte dhe cikli i grafikave kushtuar Skënderbeut. Ato do të ilustronin poemën e Naimit, dedikuar Skënderbeut.

Për arsye kohe, grafisti Taso nuk mundi të realizonte në kohën e kërkuar serinë e gravurave të nisura. Nga 12 të tilla, ai mundi të realizonte 4-5, gjë që ishte e pamjaftueshme për t'u marrë në konsideratë nga botuesit. Arsyeja e ngadalësimit të realizimit të tyre lidhet me tekniken shumë të ndërlikuar dhe indirekte që artisti zgjodhi që të ilustronte poemën. Por

*Projekti i nisur që në vitin 1980, me kërkesë të shtëpisë botuese "Naim Frashëri"*

kjo histori u desh të përfundonte mbas 30 vjetësh, në rastin e 550-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, vit jubilar i shpallur prej shtetit shqiptar. Hera-herës, në kohë të ndryshme Taso i rikthehej temës fort të pëlqyer mbi historinë e jashtëzakonshme të heroit kombëtar. Me gjithë punën e gjatë për realizimin e tyre, përsëri Taso ende thotë që ka për të shtuar dhe 10 fletë të tjera për të qenë i qetë dhe i sigurt

në fuqinë tërësore të ciklit. Brenda ciklit ai ka përgatitur një pjesë të mirë të boceteve dhe skicave përgatitore të disa skenave fort dramatike dhe episode kulmore heroizmi, tradhtie, rrethimesh, luftërash dhe tragjediash të asaj epoke. E veçanta e kompozimeve grafike konsiston në protagonizmin e dukshëm të popullit luftarak, rrotull udhëheqësit të luftës 25-vjeçare kundër superfuqisë bar-

bare të shekullit të 15-të. Gravurat janë të gdhendura sipas mënyrës klasike në panele druri natyral, dardhë dhe panje. Gravurat e famshme të artistit gjerman të shekullit të 16-të, Horst Jansen shumë të publikuara në tekstet mësimore kanë ndikuar disi në këndvështrimin e të parit të grafikës dhe tek Taso. Përpjekja për një kohë të gjatë e autorit për të realizuar një cikël solid, serioz dhe me pretendime profesionale ka bërë që kërkimet formale grafike të jenë sekondare ndaj synimit për të modeluar dhe konstruktuar skena komplekse shumëfigurale.

## KUMBARO I DORËZON DETYRËN MARGARITIT

Pas më shumë se 5 vitesh në krye të Ministrisë së Kulturës, Mirela Kumbaro i ka dorëzuar detyrën ministres së re, Elva Margariti. Gjatë fjalës në ceremoninë e organizuar me këtë rast, Kumbaro evidentoi disa prej arritjeve të punës së saj, si dhe falënderoi gjithë ekipin me të cilin punoi. "Ajo që nuk kisha arritur të artikuloja më parë, sikurse e bëra kësaj radhe, ishte që pa e thënë si të tillë, kam punuar çdo ditë si të ishte dita ime e fundit këtu, me shqetësimin se mos kjo ishte dita e fundit dhe më ngelen ca gjëra pa bërë. Kjo ka qenë thellë-thellë motori i atij presionit që ju ndoshta keni ndjerë nga

unë; që të bëhet dhe kjo të bëhet dhe ajo. Fantastike është që edhe unë kam ndjerë të njëjtin presion nga ju. Jemi ministria me buxhetin më të vogël, por me vizibilitetin më të madh. Secili nga ju ka qenë një potencial fantastik profesional dhe shpirtëror. Kjo ka bërë që ne të realizojmë gjithë ato gjëra bashkë", u shpreh Kumbaro. Ministria e re, Elva Margariti vlerësoi në Kumbaros dhe theksoi se sfida e saj e vetme në krye të Ministrisë së Kulturës është të arrijë të mbajë të njëjtin ritëm si paraardhësja. "Shikoj sot një



detyrë shumë të madhe që më është ngarkuar dhe ndiej mbi të gjitha nder, nder se më është besuar një ministri me buxhet të vogël, por me përgjegjësi të madhe. Punët e mira bëhen me ekip. Unë besoj se

së bashku do të ndërtojmë vazhdimësinë e një pune, që ju e keni nisur, që Mirela e ka nisur dhe e ka çuar përpara me shumë përkushtim e me shumë rezultate. Kjo për mua është e vetmja sfida, të arrijmë të mbajmë të njëjtin ritëm", tha Margariti. Gjatë ceremonisë u shfaq gjithashtu edhe një klip, ku ishin përmbledhur disa prej momenteve kryesore që shënjonin punën e Mirela Kumbaros në krye të Ministrisë së Kulturës për afro gjashtë vjet. Kumbaro është ministria më jetëgjatë në këtë dikaster që prej vitit '92.



# BLUE TOOTH


Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 644

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 19 Janar 2019

EDHE SINGLE DHE E LUMTUR! MERRNI TË GJITHË SHEMBULL NGA XHESIKA BERBERI!



RREFEHET  
MUSA ZENELI:



JAM I FEJUAR DHE BASHKËJETOJ PREJ PESË MUAJSH




## SFIDAT E 'INSTAGRAMIT'

### Më në fund shohim fytyrat e vërteta të VIP-ave

Nga Ami me Ermalin te Rozi me Fjorin, kush tregoi se koha është vetëm një numër. Para një dekade kishin tjetër pamje, ja transformimet drastike të të famshmëve

'E DIELL'  
Ç'PO NDODH?  
SHTYHET PROGRAMI  
I SHUMËPRITUR





Nga Ami me Ermalin te Rozi me Fjorin, kush tregoi se koha është vetëm një numër

# Rrofshin sfidat e 'Instagramit'! Më në fund shohim fytyrat e vërteta të VIP-ave

Para një dekade kishin tjetër pamje, ja transformimet drastike të të famshmeve

Pamela Aliaj

**N**ik është hera e parë që sfidat apo tenden cat më të reja të rrjeteve sociale na marrin mendjen duke na përfshirë në vorbullën e tyre. E tillë është edhe sfida më e re e 'Instagramit', për të postuar foto para 10 viteve. Për të qenë të sinqertë jo të gjithë e marrin përsipër të përfshihen në këtë sfidë sepse do pak kurajë. Kjo jo sepse kemi komplekse të shfaqim të shkuarën, por të nxjerrim në shesh të vërtetën e ndryshimeve drastike të pamjes së tanishme. Kjo gjë ka ndodhur edhe më VIP-at tanë të cilëve nuk i intereson kjo pjesë dhe e kanë parë këtë sfidë si një mënyrë edhe për të rikujtuar kohët e 10 viteve më parë, ndaj të shumtë kanë qenë ata që janë bërë pjesë e saj këto ditë. Ajo që na ra në sy tek po shikonim postimet e tyre në profilet e 'Instagramit', ishin edhe fotot e



çifteve të njohura, si një formë për të kujtuar edhe vitet e hershme të dashurisë, të cilët kishin një dekadë së bashku. Bieta me vetulla të holla, Albani me kaçurrela, Ami me po të njëjtën buzëqeshje ndërsa Ermali pak më i dobët se tani. Ndërsa disa të tjerë si Luana Vjollca kemi zgjedhur vetë t'ua bëjmë këtë sfidë duke qenë se moderatorja nuk ka preferuar të ndajë ndryshimin 360 gradë të ndodhur me pamjen e saj. Më poshtë po ju sjellim disa prej tyre ku tek të shumtë një dekadë s'i ka

prekur pothuajse fare, disa duken edhe më të këndshëm tani e disa të tjerë më mirë i gjykoni vetë nëse arrini të bëni lidhjen me atë që kanë qenë më parë.

## FIORI DARDHA DHE ROZANA RADI

Gazetarja e njohur Fiori Dardha është bërë pjesë e sfidës më të re në rrjete sociale "10 vjet më parë" ku shumë nga personazhet e njohur kanë publikuar fotot e tyre. Por Fiorin nuk e shohim vetëm në këtë foto të 2009. Ajo ndodhet së bashku me këngëtarën dhe miken e saj të ngushtë Rozana Radi. Përveç fotos ajo ka shkruar: "Eh moj Rozana Radi ç'dekolte ke patur në 2009! Në 2019 sikur ngjajmë njëçikë me foton nr 2. Tek foto nr 3 e gjeve edhe më shumë veten... #10yearschallenge #fioridardha#rozanaradi,"-përfundon Fiori në rrjete sociale.

## ROZA LATI


Edhe moderatorja e njohur

Roza Lati është bërë pjesë e sfidës më të re në 'Instagram' 10 vite më parë, e cila konsiston në publikimin e një fotoje të 10 viteve më parë. Në fotografirinë që Roza ka publikuar dikush nga ndjekësit e saj i ka komentuar se më parë ishte më e mirë, duke qenë se ishte "BIO". Roza nuk e ka pritur aspak mirë këtë koment dhe kritikën e tjera që i janë bërë, sepse i janë dukur pa vend. "I kam bërë buzët që 20 vjeçe. Edhe vetullën e kam pasur të punuar. Njeriu rritet. E mos na çani dërrasat ç'e ke gjithë këtë make up, ç'je bërë kështu"... S'do dal të pi kafe te lagjja me ju. Do dal në

ekran. Ekran i ka rregulla! Ka blice dhe drita nivel tjetër nga dritat e rrugëve që dilni ju o milet! Bëni dallimin! Unë punoj në televizion. Make up dhe krehja dhe flokët janë procese të punës!", - ka shkruar Roza. Më pas ajo ka shpjeguar se nuk i mirëpret të tilla komente, sepse nuk dinë të bëjnë kritikë e duhura dhe reagimi i saj është gjithëpërfshirës, sepse nuk ka asgjë personale me askënd.

## RUDINA DEMBACAJ

Pjesë e kësaj sfide është bërë edhe aktorja dhe moderatorja Rudina Dembacaj. Rudina ka postuar një foto të





10 viteve më parë ku nuk shihet me të njëjtat linja trupore që ka sot, duke i lënë ndjekësit gojë hapur me ndryshimin. Kujtojmë që e ftuar në "Xing me Ermalin", muaj më parë, Rudina tregoi se dikur ishte mbipeshë, peshonte 89 kile. Sa ka ndryshuar!

**FLORIANA GARO**

Edhe bukuroshja Floriana Garo nuk ka ngurrar të bëhet pjesë e sfidës më të fundit të 'Instagram-it' për të zbuluar fotografi të 10 viteve më parë. Në fakt, duket sikur historia tek Floriana është përsëritur në një farë mënyrë, sepse njësoj si tani edhe 10 vite më parë ajo nuk ka jetuar në Shqipëri. Nga viti 2002 deri në 2010 ajo ka jetuar në Amerikë së bashku me familjen e saj. Floriana është diplomuar në "City College of Neë York" dhe aty ka luajtur edhe në


plastike në fytyrë dhe e veshur ekstravagante, stil ky që e ka rrajtur edhe në ditët e sotme.

**ADA DEDA**

Vajza e ish-deputetes demokrate Albina Dedës shpesh është vënë përballë sulmeve. Ada Deda është një nga modelet më sexy. Pamja e saj ka ngritur pikëpyetje duke bërë të dyshohet se ka kryer operacione plastike për të prekur perfeksionin. Por sfida më e fundit '10 vite më parë' duket se ka bërë të gjithë të heshtin. Ajo ka ndarë një foto kur ishte vetëm 9 vjeç. Nga foto dallohet se nuk ka humbur asnjë nga tiparet e modeles që sot është 19 vjeçe.

**ORNELA BREGU**


Ornela Bregu, motra e politikanes Majlinda Bregu ka befasuar me ndryshimin e saj



Luana Vjollca që për vite të tëra vazhdon të mbetet një prej emrave më të përmendur dhe një prej fytyrave që më së shumti është përcjellë në ekranet televizive ka kohë që komentohet me të madhe. Luana Vjollca nuk është se nuk i luan këto lloj sfidash, por me sa duket tek kjo e fundit ka ngecur paksa. Marrë parasysh se trendi i ndërhyrjeve kirurgjike tek shqiptarët nuk ka shumë vite që ka nisur, moderatoren Vjollca duket ta ketë kapur këto 5-vitet e fundit. Edhe pse asnjëherë se ka pranuar se ka bërë ndërhyrje kirurgjike kanë dal plot imazhe që tregojnë ndryshimin drastik të saj. Nëse hamendësojmë, del që kjo e fundit nuk është se s'ka dëgjuar për "Sfidën me imazhin para 10-viteve", por nëse do ta publikonte një të tillë a thua a do të ishte e ngjashme me Luanën që e shohim sot?! E dalloni dot?

**ENCA HAXHIA**

Edhe këngëtarja Enca Haxhia ka vendosur të publikojë një fotografi të saj si është dukur 10 vite më parë. Fiks para dhjetë vjetëve, Enca ishte një vogëlushe e cila kishte filluar ta shohë veten si një yll të muzikës, që sot ia ka arritur. Në një nga pyetjet e bëra



parë i shohim të dy ku duken mjaft ndryshe nga si janë sot. Në ditët e sotme ata kanë edhe një djalë, Kroj Artin e vogël.

**LEDINA ÇELO**

Një tjetër provë që Ledina Çelo mbetet akoma një super-femër është dhe sfida e 10 viteve. Në foton nga viti 2018, Ledina shihet të ketë pozuar komplet e zhveshur, në një fotosesion të realizuar në Londër. Koha siç duket nuk ka lënë shenjë tek Ledina, pasi ajo tashmë është nënë e dy fëmijëve dhe po duket gjithnjë në formë.

**BLEONA QERETI**

Edhe këngëtarja Bleona Qerreti i është bashkuar sfidës së '10 vjetëve'. Bleona Qereti



skuadrën e volejbollit të universitetit. Pikërisht nga kjo kohë Floriana ka vendosur të publikojë një fotografi dhe duket se gjatë 10 viteve nuk ka ndryshuar asgjë në tiparet e saj, përveç ngjyrës së flokëve. Kujtojmë se rreth dy vite më parë Floriana u largua për një jetë të re në Zvicër, ndërsa në 2018 u bë nënë për herë të parë.

**LINDA REI**

Linda Rei është një prej personazheve më të komentuar të mediave rozë, për shkak të jetës së saj personale dhe profesionale. Ajo vazhdon të komentohet shumë në rrjetet sociale për fotot e nxehta që poston dhe sigurisht që nuk kishte si i bënte bisht kësaj sfide. Në foton e 10 viteve më parë që ajo ka ndarë më fansat, duket bionde, pa disa operacione

në 10 vite. Ornela ka ndarë një foto të vitit 2008 dhe duket krejtësisht ndryshe. Hijeshia e saj nuk ka humbur përgjatë këtij dhjetë vjeçari, tashmë që është nënë e dy fëmijëve. Ornela prej disa vitesh jeton në Spanjë me familjen, duke krijuar kështu mungesë në publikun shqiptar.

**LUANA VJOLLCA**

Ajo konsiderohet si një nga moderatorët më joshëse sh-



bashku me bashkëshortin e saj, Ermal Mamaqi. Duket se vitet nuk kanë ndikuar fare tek çifti!

**BIETA ME ALBANIN**

Sfidës së fotove të 10 viteve më parë i është bashkuar edhe moderatorja Bieta Sulo. Ajo ka publikuar një foto një foto të vitit 2009 ku shfaqet së bashku me partnerin e saj Alban Dudushi. 10 vite më

ka publikuar një imazh në rrjetet sociale para disa viteve si dhe si duket sot. Në llogarinë e saj 'Instagram', ajo ka publikuar një foto se si ka qenë vitin 20018-të dhe si duket tani. Këngëtarja, ka marrë komente të shumta nga fansat e saj, pasi që Bleona njihet si njëra nga fytyrat e estradës shqiptare tejet në formë.



“Shihemi së shpejti!”, formati nuk ka ndryshuar, por surprizat janë të shumta këtë vit

# Shtyhet programi i shumëpritur, ç’po ndodh me ‘E diell’

*Pritej të niste në 27 janar, ja kur hap siparin edicioni për 2019*

Pamela Aliaj

**D**eri para pak kohësh të gjithë ç’dinim për “E diell” ishte se do të prezantohej nga Edi Manushi, Fjoralba Ponari, Xhilda Luzi, Nevina Shtylla, Ervin Kurti e shumë të tjerë. Ndërkaq nuk mjaftohen me kaq, sepse pjesë e këtij programi është edhe ish-moderatorja e “Adrenalinë” në INTV Gentjana Pepa, moderatori i “Pushime on Top” Flori Gjini, ish-balerini i trupës së “Të dielës shqiptare” Enea Malaj etj. Edhe pse në promo nuk bëhej e ditur data, por një nga moderatorët kishte në InstaStory se edicioni do të niste në të dielën e fundit e muajit, 27 janar. Por, gjërat duket se do të ndryshojnë. E pyetur nga “Bluetooth” për “Gazeta Shqiptare”, një nga moderatorët, Xhilda Luzi, nëse programi ka patur ndonjë problem të brendshëm që u shty është përgjigjur: Jo, asnjë problem. Thjesht po përgatitemi maksimalisht për të bërë më të mirën. Duke qenë format i ri po merr kohën e nevojshme për të arritur pritshmëritë që ka publiku... Siç e thotë dhe spoti “Shihemi së shpejti”. Ndërkaq në mediat rozë qarkullon lajmi se programi do të nisë në mes të muajit shkurt. Shkak për këtë thuhet se është paqartësia e rubrikave, temave që do të preken, roleve të secilit prej personave të përfshirë dhe skenogra-



fia. Nga ana tjetër Fjoralba Ponari është shprehur për një media rozë se “skaleta e programit është gati”. Pra, nuk ka paqartësi dhe rrëmujë të panevojshme tek pjesa e ndërtimit të programit. “Skenografia është ajo që mund të na detyrojë të startojmë në 3 shkurt”, shtoi ajo duke konfirmuar kështu se ndoshta “E diell” shtyhet për në fillim të muajit të ardhshëm.

# E DIELL

SË SHPEJTI



Në lidhje me orarin – për të cilin shprehet se nuk do të jetë një program maratonë, siç pritej, por do të transmetohet nga ora 15:40-18:00 – Ponari preferoi të mos jepte detaje të mëtejshme. Ndërkaq kujtojmë se emisioni maratonë i së di-

elës – që dikur iu besua emrave si Adi Krasta, Xhemi Shehu, Arbana Osmani, Alban Dudushi, Luana Vjollca etj. – këtë vit vjen me një frymë të re. Në promo thuhet se “emisioni nis së shpejti”, megjithëse nuk është më sur-

prizë por të gjithë po e presim të nisi në 3 shkurt. Të shohim se ç’supriza na rezervon programi i shumëpritur në Topchannel, i cili këtë vit mesa duket do të sjellë një risi që s’është parë më parë me shumë moderatorë.





## Bashkëpunim i ri në horizont?

# Tayna dhe Noizy do të bëjnë hitin e 2019

Vitin e kaluar, në 18 dhjetor Tayna publikoi bashkëpunimin e saj me Ledri Vulën ndërkohë që mund të jetë duke u përgatitur për një tjetër projekt me një nga reperët e njohur shqiptar. Dy reperët më të suksesshëm të momentit, Noizy dhe Tayna duket se po mendojnë për një bashkëpunim. Ishte faqja e Instagram-it, "Hip Hop Shqip", e cila njofton për lajmin duke shkruar: "Tayna ka folur me Noizy-n për një bashkëpunim. Ka shumë shanse të ndodhë shumë shpejt!". Sipas njoftimit duket se ka qenë Tayna ajo që ka kërkuar të bashkojë forcat me reperin nga Shqipëria. Ndërsa lajmi ende nuk është konfirmuar, duket se ka entuziazmuar shumë fansat e këngëtarëve.



## Edhe single dhe e lumtur! Merrni të gjithë shembull nga Xhesika Berberi!

Modelja shqiptare, Xhesika Berberi, e cila aktualisht jeton në SHBA, i kishte dhënë fund lidhjes së saj disaveçare ku ky i fundit së fundmi u fejua me një vajzë tjetër. Thuhet se arsye e ndarjes ka qenë distanca, sepse dyshja prej vitesh e jetonin këtë histori në distancë, u duk se do të mund t'i mbijetonin largësisë. Por të qenit 'single' Xhesila, e cila jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës po e shijon shumë. Madje modelja sapo ka publikuar një fotografi ku e bën këtë deklaratë: "Jam e vetme dhe më pëlqen", ka shkruar ajo! Për të marrë shembull apo jo?



## Së shpejti do të jenë përgjithmonë bashkë! Keisi jep lajmin e shumëpritur lidhur me Stresin

Padyshim që Keisi dhe Stresi janë çifti më i përfolur në media që pas fejesës së tyre. Por ajo që të gjithë presim është se dyshja ka në plan edhe një dasmë që pritet ta mbajnë shumë shpejt dhe që do t'i bashkojë përgjithmonë. Lajmin e ka dhënë vetë partnerja e Stresit në Instastory, aty ku u ka dhënë përgjigje shumë pyetjeve të ndjekësve të saj dhe të reperit. Me interes për ne ka qenë pyetja se kur do të bëhen prindër, dhe Keisi me një foto papuçesh të vogla Calvin Klein ka dhënë këtë përgjigje: "hahah do të bëjmë dasmë njëherë, faleminderit!" Bukuroshja ka treguar sa shumë e merr malli për të fejuarin e saj dhe sa herë takohen gjatë gjithë vitit, duke qenë se ajo jeton në SHBA. "Dikur kur kishim marrëdhënien larg syrit të publikut dhe familjeve dhe unë isha në shkollë, normalisht takoheshim më rrallë, por tani unë kaloj gjysmën e vitit andej dhe shumë shpejt do të jemi 365 ditët e vitit bashkë. Normal që më mungon, e kam botën time!".



Flet ish-banori i 'Big Brother 9': Do kthehem në Shqipëri për biznes

# Rrëfihet Musa Zeneli: Jam i fejuar dhe bashkëjetoj prej pesë muajsh

Pamela Aliaj

Tashmë prej dy vitesh nuk është më pjesë e ekraneve shqiptare një nga reality show-t më të ndjekur në Shqipëri, "Big Brother". Por vëmendja nga ish-banorët e saj, të cilët bënë shumë bujë me çiftet që krijuan brenda show-t dhe ndarjet e mëvonshme të tyre, na bënë t'i ndjekim edhe sot. Një ndër ta është edhe djaloshi simpatik, Musa Zeneli. Atëherë ishte i lidhur me vajzën nga Shkodra, Dona Pjetri, por lidhja e tyre, ashtu si e shumë të tjerëve nuk zgjati shumë. Po ku është sot Musa? Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", ish-banori i Big Brother na rrëfen se tashmë zemrën ja ka rrëmbyer një vajzë nga Roma dhe me të është edhe fejuar e po bashkëjetoj. Jo vetëm kaq, por Musa na tregon se me të ka marrë dhe një lokal në të cilin ai është duke punuar gjatë gjithë kohës. Për më tepër në intervistën e mëposhtme:

**Prej kohësh jeni duke jetuar në Itali, pas shpërndarjes nga Shqipëria. Me çfarë jeni duke u marrë për momentin?**

Po, kam gati një vit e gjysmë që nuk kthehem në Shqipëri. Kjo sepse kam marrë një lokal së bashku me të dashurën time dhe nuk kam shumë kohë për të lëvizur. Jam shpesh në punë.

**Keni ndonjë plan të ktheheni?**

Kam në plan të kthehem, por jo për të qëndruar. Do kthehem për ndonjë biznes apo gjë të tillë.

**A keni pasur ndonjë propozim pasi dolët nga "Big Brother" apo dhe më vonë?**

Nuk kam pasur propozime, sepse nuk kam qëndruar shumë në Shqipëri. Sa mbaroi "Big Brother", gati dy muaj më vonë u largova. Nuk kam parë e s'kam pasur mundësi, sepse koha që qëndrova ishte shumë e shkurtër.

**Në 'Instagram' postuat së fundmi një foto me të dashurën tuaj. Mund të na thoni si e njohët, historia juaj e dashurisë?**



*"Është një histori e vërtetë dashurie që nuk e kam pasur asnjëherë më parë"*

Të dashurën time e kam njohur nëpërmjet shokut tim. Jemi bashkë prej gati pesë muajsh dhe jetojmë bashkë në Romë. Kemi marrë një shtëpi bashkë dhe një lokal bashkë me të. Mund të them që është një histori e vërtetë dashurie që nuk e kam pasur asnjëherë më parë.

**A keni plane për fejesë**

**apo bashkëjetesë?**

Jemi fejuar tashmë dhe bashkëjetojmë bashkë.

**Keni shumë tatto në trup, cili është më i veçanti për ju? Ç'kuptim ka ai?**

Tatuazhi im më i veçantë dhe më kuptimplotë është dedikuar babit. E kam vizatuar në krah në formën e një anijeje brenda një shisheje.

**Duket se jeni shumë i tërhequr nga modelingu. Është një ndër pasionet tuaja?**

Po, më tërheq pak modelingu. E kam pasur dëshirë

modelingun dhe botën e televizionit. Më pëlqen kur m'i bëjnë fotot dhe t'i postoj në 'Instagram'. Nuk është se e kam fiksuar apo pasion, por më pëlqen shumë.



## E pranon Keisi Medini, tregon të vërtetën për pamjen e jashtme

Vajza e këngëtarit shumë të njohur për publikun, Sabianit ishte e ftuar së fundmi në emisionin e pasdites "Ftesë në 5". Keisi Medini ka lançuar këngën e saj të parë në bashkëpunim me Seldin dhe gjatë intervistës në studio rrëfeu emocionet dhe pritshmëritë për klipin e ri, i cili është pëlqyer nga publiku. Ndërkohë që komentonte fotot e saj në ekran, moderatorja Bieta Sulo e pyeti Keisin nëse përdorte fotoshop nëpër poza dhe për cilën pjesë të trupit e përdor më shumë. "Për të gjitha. Tani, jo të gjithë dalim mirë në fotografi, të themi të drejtën. Çdo femër do bëjë pak fotoshop... dhe bëj çdo lloj fotoje të mundshme." - ka rrëfyer Keisi duke qeshur.

## Zhvishet Rita Ora, merr pozë provokuese para pasqyrës

Në fund të një dite shumë të ngjeshur në New York, këngëtarja e njohur Rita Ora ka pozuar para pasqyrës pothuajse nudo. Rita Ora ka zgjedhur që t'i heq rrobat për ta realizuar një fotografi para pasqyrës. Për këngëtare Rita Ora provokimet tashmë janë bërë pjesë e përditshmërisë së saj. Me sytjena para pasqyrës, këngëtarja shqiptare u ka kërkuar një favor ndjekësve të saj të shumtë. "Koha për të larë këtë. Kam për t'u zgjuar në ora 05:00 të mëngjesit, më dëshironi fat", -ka shkruar Rita pranë imazhit ku shihet vetëm në të brendshme.



## Nënë për herë të dytë?

# ZAIMINA

## rrëfen planet e të ardhmes

Për herë të parë në janar të 2018, Zaimina Vasjari u bë nënë për herë të parë. Pas lindjes së Khloe, Zaimina është mjaft aktive në rrjetet sociale dhe shpesh ndan me ndjekësit momente nga jeta e përditshme. Së fundmi ishte e ftuar në emisionin "Lart e Poshtë" ku zbuloi disa detaje interesante nga jeta e saj profesionale por edhe private. Gjatë intervistës këngëtarja tregoi dëshirën e madhe që ka për një fëmijë të dytë. Pas vogëlushes së parë, Khloe, Zaimina ka në plan që në 2020 të mbajë në krah fëmijën e saj të dytë. "Do të doja që në vitin 2019 të kisha një shtatzëni që në 2020 të kem edhe një bebe tjetër, por gjërat do të shihen nga angazhimet e punës dhe të gjitha gjërat që do të vijnë", - u shpreh bukurshja. Me sa duket këngëtarja dëshiron që të dy fëmijët e saj t'i rrisë njëkohësisht, pasi edhe Khloe është ende e vogël. Pra, shumë shpejt do ta shohim bukurshen sërish nënë. Mbase kësaj here me një djalë.



# Përgatituni të dëgjoni këngën e bashkimit

Nga Veton Surroi

(vijon nga faqja 1)

**Teksti i këngës për bashkim tingëllon më së qarti serbisht.**

1. ... legjitimohet edhe një fjalë tjetër, që ishte pjesë e paketës ndërkombëtare të "vijave të kuqe", fjala bashkim si në "bashkim kombëtar". Nga pak u prek gjatë vitit të kaluar duke ravijëzuar një sekuençë logjike: Kosova dhe Serbia këmbëjnë sa më shumë serbë e shqiptarë në shtetet e tyre respektive, së bashku me një pjesë të territorit ku banojnë dhe meqë tash do të ishin në realitete të reja, Kosova e Serbia do të kishin të drejtë të bënin çka të donin me territorin e vet. Sapo filloi ky vit dhe kryeministri i Shqipërisë e thjeshtësoi tërë procesin negociator: Kosova të përfundojë çka problem me Serbinë dhe pastaj Shqipëria e Kosova të bashkohen.

Mund të tingëllojë si muzikë për veshët e shqiptarëve të Kosovës, të frymëzuar nga metafora e mungesës historike në ngritjen e flamurit të Pavarësisë së Shqipërisë si mungesë e shtetit të përbashkët. Por, ndonëse muzika mund të tingëllojë e këndshme, duhet shikuar me shumë kujdes tekstin e këngës që ka brenda këtë formulë: një herë ndarje territoriale, pastaj bashkim. Varësisht ku këndohet, ajo do të tingëllojë tjetër, madje krejtësisht ndryshe prej këndimit paraprak.

2. Këndimi në Prishtinë do të balafaqohet me shpërputhje në tekst. Procesi negociator i tanishëm, thonë delegacionin shtetëror dhe opozita që nuk është në këtë delegacion, duhet të prodhojë njohje të Pavarësisë së Kosovës në territorin e saj të tanishëm, duhet të prodhojë njohje të pesë shteteve anëtare të BE-së, që nuk e kanë njohur dhe anëtarësimi në OKB. Rrjedhimisht, duhet të krijojë mundësinë e integritetit në NATO e BE.

Por, nëse kënga po thotë se një herë duhet të bëhet "korrigjimi" e pastaj bashkimi kombëtar, atëherë qenka një proces tjetër negociator. Për delegacionin shtetëror - dhe opozitën që nuk është pjesë e tij - nuk do të kishte ndonjë sens të negociohet për të zhdukurit e borxhet ndaj kursimeve të qytetarëve, për shkatërrime të shtëpive e për të drejtat minoritare brenda Republikës së Kosovës, në mënyrë që të sigurohet njohja e Republikës së Kosovës nga Serbia, të gjitha shtetet e BE-së dhe anëtarësimi në OKB e NATO me këtë emër, nëse ekzistua një proces tjetër negociator, i cili siguron që njëherë të



bëhet copëtimi i territorit të Kosovës e pastaj bashkimi i tij me Serbinë, gjegjësisht Shqipërinë.

Apo është fjalë për një këngë tjetër?

3. Kjo këngë ka gjasa të tingëllojë mirë për veshët në Serbi. Një proces negociator që, siç u shpreh presidenti i Serbisë, do të krijojë vijën ndarëse historike mes serbëve dhe shqiptarëve do të prodhonte një territor kompakt në Kosovë me sa më pak serbë në të dhe një territor në Serbi me sa më pak shqiptarë në të (pa përdorim të dhunës, por nëpërmjet të këmbimit paqësor territorial). Territori kompakt me shqiptarë do të kishte të drejtë të bashkimit me Republikën e Shqipërisë dhe meqë Republika e Serbisë e njeh këtë të Shqipërisë, Ser-

bia do të përmbushte një nevojë dhe një premtim njëkohësisht. Do të përmbushte nevojën që të zgjidhë çështjen e Kosovës dhe njëkohësisht premtimin që kurrë të mos e njohë Pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Kënga serbisht, pastaj do të ishte me më shumë refrene sesa ajo në versionin shqip. Bashkimi i sa më shumë shqiptarëve në një shtet do të ishte ftesë që një gjë e tillë të ndodhte edhe me Serbinë, nëpërmjet të bashkimit të Republikës së Bosnjë-Hercegovinës.

As varianti rus nuk do të tingëlonte keq. Nëse mund të bashkohen shqiptarët, pastaj serbët, çka kanë rusët që nuk mund të bashkohen?

4.

Kjo këngë nuk tingëllon mirë

gjermanisht. Një lexues i vëmendshëm i lirikës së re ballkanike do të hetojë se këngës, e cila thotë "një herë ndarje, pastaj bashkim" i mungon njëri prej përcaktimeve thelbësore të shtetndërtimit, njohja. Procesi negociator që fillon me këmbime territoriale dhe kalon e përfundon me bashkim - njëherë spastrohen çështjet me Serbinë, pastaj Kosova bashkohet me Shqipërinë - anashkalon pikën më të lartë historike të Kosovës, barazinë e Kosovës me shtetet e tjera, përfshirë Serbinë, përfshirë Shqipërinë. Pra, anashkalon të drejtën e qytetarëve të Kosovës që nëse duan të krijojnë procesin dhe institucionet e bashkimit me Shqipërinë, në çfarëdo formati dhe me çfarëdo shpejtësie që të dëshirojnë - union doganor alla BE, bashkim konfederal, bashkim në një shtet. Sot, pas dhjetë, njëzet e pesëdhjetë vjetësh.

Andaj gjatë vitit të kaluar përgatit legjitimitet të fjalës "korrigjim" u shmang vëmendja nga fjala "njohje", si në njohje të ndërsjellë. Dhe andaj, gjatë këtij viti, me legjitimitetin e fjalës "bashkim" do të shmanget vëmendja sërish nga fjala "njohje". Kjo nuk është rastësi. Është pjesë e një përpjekjeje që me një proces "shpejt e shpejtë" të krijohet një marrëveshje që nuk do të trajtojë okupimin dhe luftën e Kosovës - parakushte për të arritur një marrëveshje paqeje - por do të zbrisë tërë problemën shekullor në një

Kënga serbisht, pastaj do të ishte me më shumë refrene sesa ajo në versionin shqip.

Bashkimi i sa më shumë shqiptarëve në një shtet do të ishte ftesë që një gjë e tillë të ndodhte edhe me Serbinë, nëpërmjet të bashkimit të Republikës serbe në Bosnjë-Hercegovinë.

emërtues të përbashkët, që shqiptarët të jetojnë me sa më pak serbë, dhe serbët me sa më pak shqiptarë, çaqe këto të çdo ideologu serbomadhi që nga themelimi i shtetit serb në shekullin XIX, çaqe të manifestuara në luftën e fundit të Kosovës dhe dëbimin me dhunë të një milion shqiptarëve nga Kosova.

5.

"Bashkimi", si në bashkim kombëtar, kështu, hyn në stadin e vet të tretë të jetës si koncept politik. Përgjatë shekullit XIX dhe një pjesë të madhe të atij XX ishte synim i rilindësve, nacional-demokratëve, komunistëve, fashistëve, romantikëve, ëndërrimtarëve, poetëve, ekonomistëve e të tjerëve. Pas rënies së komunizmit deri më sot u shndërrua në kërcënim: o do të pavarësohet Kosova, o do të bëhet bashkimi kombëtar; o do të integrohet Shqipëria në BE, o do të integrohen të gjithë shqiptarët në një shtet, o do të fitojnë të drejtat e veta shqiptarët në Maqedoni, o do të bëhen pjesë e Shqipërisë.

Tash, në stadin e tretë merr kontura që nuk do të mund të besoheshin gjatë njëqind vjetëve. Në vend të njohjes së ndërsjellë dhe të drejtës së qytetarëve të Kosovës të jenë të barabartë me qytetarët e shteteve të tjera, do t'u këndohet kënga e bashkimit. Në versionin serbisht, do t'u thuhet se mund të jenë të barabartë vetëm si shtetas të Shqipërisë. Në versionin shqip, do t'u thuhet se u gjet zgjidhja për të gjitha problemet e Kosovës (OKB, BE, NATO) e njëkohësisht u gjet formula se si të përmirësohet çdo gjë tek qeverisja e shqiptarëve; dy shtete të kapura me institucione të brishta e të sulmuara me sukses nga krimi i organizuar do të funksionojnë si një shtet funksional ditën kur pranohet plani serb i deklamarur shqip: një herë ndarje, pastaj bashkim.

Njohja? Kush kërkoi këngën njohja?

Mund të tingëllojë si muzikë për veshët e shqiptarëve të Kosovës, të frymëzuar nga metafora e mungesës historike në ngritjen e flamurit të Pavarësisë së Shqipërisë si mungesë e shtetit të përbashkët. Por, ndonëse muzika mund të tingëllojë e këndshme, duhet shikuar me shumë kujdes tekstin e këngës që ka brenda këtë formulë: një herë ndarje territoriale, pastaj bashkim. Varësisht ku këndohet, ajo do të tingëllojë tjetër, madje krejtësisht ndryshe prej këndimit paraprak.

Opinion *i* Ditës

# A ka mbaruar e Majta shqiptare prej vitit '90?!

Nga Ben Andoni

(vijon nga faqja 1)

... tonë nuk funksionon ose më saktë nuk ka funksionuar asnjëherë si e tillë, në erën demokratike. Në të gjithë historinë tonë, për shkak të konfuzionit teorik dhe shtetit të dobët, ideologjia e të Majtës dhe të Djathtës afrojnë në shumë pika, por ajo që i bën njerëzit e zakonshëm të ngatërrohen me to, lidhet me ligjëratën e tyre për trashëgiminë "e rëndë" kombëtare dhe diskursin fals për popullin. Nga ana e saj, e Majta, e tepron edhe më kur futet dhe vepron tek prona, shpesh në mënyrë të parregullt dhe në aleancën me të pasurit, që sot përcillet me partneritetin e vazhdueshëm dhe aspekt efektiv PPP. I gjithë ky mjedisi kaotik i ngjitet nga sipër trashëgimisë së socializmit si shtresëzim, duke e bërë ende të largët fizionominë e një të Majte moderne.

Fatkeqësia më e madhe është mosfunksionimi i komuniteteve të mëdha punëtore dhe ngritja e sindikatave të pavarura, që do të mund të diktonin rregulla loje, por edhe normalitete të kushteve të punës në ekonomi. Sindikatat ekzistuese, goftë edhe në atë masë të pakët që janë, rezultojnë nga më të paturpshmet sa i përket flirteve me qeveritë duke hequr një nga mbështetjet e bazës ideologjike të së Majtës. Paradoksi më i madh është sot se qeveria e sotme socialiste, ashtu si paraardhëset sillejt si e Djathtë dhe është krejt jashtë zgjidhjes së nevojave të njerëzve, për të mos thënë të fundit: Cinike me ta.

Mbi të gjitha, e Majta shqiptare, ka ardhur koha realisht të tregohet unike kur përballet me problemet kombëtare që mundon t'i shfrytëzohë shpesh hidhur e ashtuajtura E Djathtë, teksa fiton pikë në çdo moment kaosi, siç po mundohet në këto kohë kaq të turbullta për vendin. Ose duke përcjellë gjendje të tilla pa shpresë, që na mbajnë në ngërçe aq të vazhdueshme. Si mund ta kapësh, këtë frymë negative? Përveç të gjitha elementëve, e Djathta në Shqipëri



mundohet të ngrejë dhe të glori-fikojë, siç po ndodh rëndom tek ne, institucionet e vjetra dhe të sfu-mojë gjithçka që lidhet me trashëgiminë e shkuar kundër kë-tyre institucioneve. Dhe, nuk mjafto-ohen me kaq. Retushi i madh që po i bën të shkuarës së pjesës reak-sionare dhe mbulimi i shumë fat-keqësive të kaluara, por edhe fjetja (Në fakt, konfuzioni i saj) e të ashtuquajturës së Majtë në ditët tona bën që e Djathta t'i paraqesë si vlerë mirëfilli.

Sërisht, nuk mbaron këtu. Par-tia e sotme Socialiste veç dukjes ka ndryshuar shumë duke iu drej-tuar qëndrimit ndaj të pasurve dhe zgjidhjes së problemeve të njerëzve të thjeshtë. Shembull është struktura socialiste parlamen-tare dhe ligjërimi i saj në legjisla-tiv.

E ndaj ndodh, që njerëzit e thjeshtë janë pa punë ose po i drej-tohen masivisht emigracionit, pasi idetë e maxhorancës janë më

afer interesave financiare të disa grupeve të fuqishme sesa njerëzve.

E Majta shqiptare bën reforma në dukje ose shpall të tilla, por asaj i mungojnë gjetja e fondeve për arsimin dhe kërkimin shkencor, mirëqenien sociale ndërsa ka har-ruar të shohë realisht burimet themelore sa u përket pabarazive të shumta ekonomike, sociale dhe politike. E Majta nuk ka sot një politikë të duhur të pensioneve, por edhe të taksave për të ndih-muar në krijimin e mundësive të një jetese normale ndaj punë-torëve dhe familjeve të zakonshme.

Koha e sotme nuk u jep mundë-si fashave të ndryshme të sho-qërisë që të integrohen, teksa e Majta sillejt si e Djathtë, ndërsa me reformat e veta i shpërndan pasur-itë me prioritet të kamurit ndaj të varfrit, pa mundur që këtyre të fundit t'u japë mundësi të shpresojnë.

Cili e ka dëmtuar më shumë të

Majtën? Përshtypja është se njerëzit që u munduan ta bëjnë të Majtën në vend ish-in të paqartë. Duke filluar nga Noli dhe deri sot te Rama, që pak lidhje ka me të Ma-jtën, të paktën nga mënyra e arti-kullimit, asnjë nga njerëzit e kësaj ideologjie nuk ka qenë i sin-qertë me doktrinën e vet.

Ka ardhur koha që e Majta, para të Djathtës (kjo e fundit do jetë dhe për një kohë të gjatë në kërkim të identitetit tek ne) të fokusojë qëlli-met e veta dhe të shfaqet si e Ma-jtë, duke menduar më shumë për masën dhe rregullat normale të lojës, që t'i ndijnë njerëzit e thjeshtë. Mbase qeveria e z. Rama e ka të vështirë ashtu si deputetët e tij ta kuptojnë të Majtën si ideologji, por duhet që për hir të votave të njerëzve që besojnë se i përkasin kësaj ideologjie, të ruajnë atë trashëgimi të pakët që ka mbetur prej së Majtës së vërtetë. Po, në fakt, a ka mbetur më e Majtë pas vitit 1990! (Gazeta Shqiptare)

## HOROSKOPI

### DASHI

Disa persona të kësaj shenje do të kalojnë një ditë kryesisht duke u relaksuar. Megjithatë, disa të tjerë do të duhet të zëvendësojnë një koleg në punë për arsye shëndetësore. Pjesa e dytë e ditës do të kalojë mjaft mirë, duke kryer aktivitetet që ju dëshironi.

### DEMI

Demat duhet t'i kushtojnë sot vëmendje të veçantë paraqitjes së tyre. Në mbrëmje do të kenë një takim shumë të rëndësishëm, që mund t'ju ndryshojë jetën. Beqarët e kësaj shenje ka shanse të gjejnë dashurinë e jetës së tyre.

### BINJAKET

Nëse ju prishen planet për në fundjavë, mos u shqetësoni. Përpqini të mendoni pozitivisht për të realizuar diçka tjetër. Do të përjetoni momente shumë të këndshme gjatë ditës së sotme, nëse qëndroni me familjarët tuaj.

### GAFORJA

Ka gjasë që të përfshihen nga xhelozia. Përpqini ta mbani larg këtë ndjesi negative. Vendosi një tjetër qëllim vetes dhe më pas veproni menjëherë. Mbrëmja e së shtunës nuk do të kalojë ashtu sikurse e prisnit, pasi do të shndërrohet në monotone.

### LUANI

Luanët nuk duhet t'ua vënë në dukje të metat personale të rrethit të ngushtë. Kritikkat nuk do të pranojnë prej tyre. Përpqini ta kaloni fundjavën duke u argëtuar. Ka gjasë të realizoni udhëtim me partnerin/partneren tuaj, i/e cila do t'ju kënaqë pafund.

### VIRGJERESHA

Dëshirat e Virgjërës have do të jenë shumë ambicioze sot. Nëse kërkoni diçka nga fati, mund të zhgënjeheni. Presioni i panevojshëm nuk është i mirëpritur në marrëdhëniet personale. Nëse po përpqini të fitoni dashurinë e dikujt, mos e nisni atë, pasi nuk do të merrni rezultatin e duhur.

### PESHORJA

Peshoret mund të mërzhiten paksa sot, për shkak të një dite monotone. Megjithatë, mund të shfrytëzoni ditën duke bërë plane për ditën në vijim. Në mbrëmje do t'ju telefonojë dikush, që do t'ju bëjë të mendoheni gjatë.

### AKREPI

Fillimisht duhet të mendoni për veten, pastaj për të tjerët. Do të ndiheni shumë të lodhur në fund të ditës, pavarësisht se do të kenë plot momente argëtuese. Sot mund t'ju vijë edhe një ofertë shumë e mirë për t'u bërë pjesë e një eventi.

### SHIGJETARI

Disa Shigjetarëve do t'ju buzëqeshë fati gjatë një loje. Megjithatë, mos e teproni duke e provuar disa herë. Në mbrëmje do t'ju ndihmojë dikush që e kenë mbështetur më parë.

### BRICJAPI

Do të mbështetni nga shumë persona sot, pasi të paraqisni disa ide në rrjetet sociale. Mund të përballeni me disa probleme në shtëpi. Sa i përket anës romantike, gjithçka do të shkojë ashtu siç dëshironi.

### UJORI

Sot nuk do të kenë dëshirë të dilni. Do të dëshironi vetëm të qëndroni në shtëpi. Megjithatë, gjithçka do të ndryshojë në mbrëmje, pasi do të takoni dikë që nuk e keni parë prej vitesh ose do të gjeni diçka që e kërkoni prej kohësh.

### PESHQIT

Në marrëdhëniet tuaja personale mund të përballeni me disa situata konfuze. Mos dilni në përfundime pa pasur dëshmi. Sa u përket disa çështjeve të vogla, do të kenë shumë fat.

BLUE TOOTH  
THASHETHEME  
MADE IN  
ALBANIA

te rejat nga jeta ipave

© 2018

**VENDIMET**

Partizani ka kryer se ancën e fundit stërvitore në Antalia dhe dje pasdite është rikthyer në atdhe pas 2 javësh përgatitje në Turqi, ku mundi të zhvillojë dhe tre takime miqësore të një niveli të lartë. Stafit teknik është shumë i kënaqur me atë që ekipi ka shfaqur në këtë fazë përgatitore dhe me rikthimin do të nisnin dhe përgatitjet për ndeshjen e parë të fazës së tretë, transfertën delikate të Korçës, ku i pret Skënder-



**Faza në Antalia ka shkuar mirë, por përforcimet...**

**Merkatoja e Partizanit rrezikon të kthehet në dështim**

beu. Por nëse në aspektin teknik çdo gjë ka shkuar mirë, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për merkaton. Kanë qenë të shumtë emrat që janë lakuar si përforcime të mundshme të Partizanit në pozicione më të nevojshme si

mbrojtës i djathtë apo sulmues, por për një arsye apo tjetrën, të gjitha kanë dështuar me sukses të plotë. Nga ganezi Kuame, të holandezi Ligeon, boshnjaku Hanxhiç, austriaku Simkoviç, apo edhe Jetmir Krasniqi i Luga-

nos, të gjithë janë emra që u lakuan si përforcime të mundshme për të kuqtë, madje u tha se me disa prej tyre firma ishte vetëm çështje orësh, por orët u shndërruan në ditë ndërsa ditët në javë dhe trajneri Gega vijon të

ketë mangësi në grup, gjë që e shfaqti me diplomaci dhe në intervistën që vetë klubi i kuq bëri me teknikun, ku deklaroi se ishte i kënaqur nga disiplina dhe impenjimi i tyre, por pa dhënë asnjë detaj më shumë. Merkatoja mbyllet më 31 janar dhe natyrisht që ka ende kohë për të sjellë elementë, por me mbarimin e fazës përgatitore dhe ndeshjen e parë të kampionatit që po troket, do të jetë gjithnjë e më e vështirë adaptimi i tyre me grupin aktual.

Orges Shehi premtom një ekip ndryshe që nga përballja e parë zyrtare ndaj Partizanit

**Paqe në miqësore, Teuta e Skënderbeu masin forcat**

*Shkëmbi: I lumtur me qëndrimin e Amadu Latif*

Teuta dhe Skënderbeu janë ndarë në një barazim pa gola në ndeshjen e sotme miqësore që zhvilluan të dy ekipet si pjesë të përgatitjeve për rifillimin e sezonit. Një duel i luftuar në Durrës që dhirimi emocione, por jo gola, me durrsakët që u ndalën dy herë nga shtylla. Në pjesën e parë ishte Jazhxi që goditi një të tillë pas një goditje nga këndi, ndërsa në të dytën, Traore u ndal përsëri para katërkëndorit të korçarëve duke mos arritur që të dërgonte topin në rrjetë në të njëjtën mënyrë. Teuta u shfaq shumë më në formë në këtë duel, ndoshta edhe për faktin se dëmtimet kanë përgjysmuar skuadrën korçare në këto ditë të fazës përgatitore dhe trajneri Shehi nuk kishte shumë alternativate në dispozicion duke u besuar të rinjë si zëvendësues. Gjithsesi, edhe Teuta nuk e ka mbyllur pa probleme duelin e sotëm, pasi Avdyli la i dëmtuar fushën e lojës që në pjesën e parë, ndërsa Sidibe në fundin e takimit shqetësoi jo pak me dëmtimin e tij duke dalë edhe ai i shoqëruar nga stafit mjekësor.

**STAFI: DO JEMI GATI PËR PARTIZANIN**

Trajneri i Skënderbeut, Orges Shehi, premtom se



skuadra e tij do të bëjë maksimumin që të kthehet përsëri në pozitën kryesuese në klasifikim, edhe pse ka shumë lojtarë të dëmtuar apo të tjerë që nuk janë në kondicionin e duhur. Kjo është një ndeshje që i jep

fund kësaj minifaze. Jemi të kënaqur, por duhet të bëjmë akoma më shumë për t'u korrigjuar aty ku duhet. Kemi shumë mungesa, për fat të keq kemi edhe lojtarë jo në kondicionin e duhur. Kemi afruar dy lojtarë, por nuk

janë në 100% e vet, nuk janë në formë se vijnë nga pushime më të gjata sa duhet ndaj nuk janë në formë. Këto janë përforcimet, do të mundohemi të afrojmë të tjerë ku na nevojiten. Por shpresa më e madhe është

miera e pjesës së dytë", tha Shehi.

**SHKËMBI I LUMTUR QË LATIF QËNDRON**

Trajneri i Teutës, Bledi Shkëmbi, pas barazimit 0-0 në miqësoren me ish-skuadrën e tij, Skënderbeun, ka folur për gjendjen e të tijve dhe çështjet e sulmuesit Amadu Latif e mbrojtësit Reanto Arapi. "Mendoj që morëm atë për të cilin kishim si qëllim në këtë miqësore: kemi parë gjendjen e ekipit, ndonjë lojtar të ri që kemi afruar. Shkoi deri diku mirë. Në ndeshjet miqësore shihen defektet dhe ne patëm disa defekte sot, që duhet t'i rregullojmë. Latif? Ne si staf teknik na vjen mirë që ai do të qëndrojë me ne edhe në vazhdim të kampionatit. Nëse merkatoja, deri ditën e fundit të saj do të na ofrojë ndonjë lojtar më të mirë se këta që kemi, do të ishte mirë për ne. Arapi duhet të zgjidhë problemet që ka me klubin e tij në Turqi, pastaj të shohim se çfarë do të ndodhë. Mendoj që objektivi ynë është të vazhdojmë me ecurinë e fazës së dytë. Ky është synimi ynë, të kemi këtë ecuri dhe shpresoj se do ta arrijmë", - tha pas ndeshjes trajneri i Teutës, Bledi Shkëmbi.

**AFRIMI I DYTË**

**Skënderbeu firmos me Shqipërim Taipin**

Shqipërim Taipi është afrimi i dytë tek ekipi i Skënderbeut. Mesfushori i qendrës, që mund të luajë edhe para mbrojtjes, vetëm pak ditë më parë kishte prishur kontratën me ekipin e Shkëndijës, ku luante që nga vera e 2018-ës.

Mesfushori 21-vjeçar, i gjatë 1.74m, ka luajtur më parë edhe me klubet e Shkupit dhe Prishtinës, ndërsa tashmë do të jetë një përforcim për korçarët në një repart ku ka shumë mungesa. Këmba natyrale e Taipit është e djathtë, ndërsa në treg kartoni i tij vlerësohet me 75 mijë euro, nga portali "transfermarkt.com". Ky është afrimi i dytë për korçarët, pas Elmir Asanit.



**I OFRON PALMIERIN JUVES**

**Çelsi nuk heq dorë nga Gonzalo Higuain**

Sipas asaj që po raportohet ditët dhe orët e fundit nga Smediat italiane dhe angleze, Higuain shumë shpejt do të jetë një lojtar i Çelsit. Gjasat janë që ai të jetë për një vit e gjysmë i huazuar nga Juventusi tek anglezët.

Por, "Tuttosport" një media shumë afër ambientit bardhezi, thotë se londinezët kanë një pistë të re për të sjellë Higuain në Angli. Duke parë që Juventusi ka një interes të madh për Emerson Palmierin, mbrojtësin e krahut të Çelsit, kërkojnë që të fusin brazilianin në tratativë. Kështu Çelsi do të shpëtojë ato 9 milionë euro që duhet të japë për huazimin e argentinianit. Nëse kjo do të ndodhë do të kemi dhe një "efekt domino" në merkato. Kështu Spinacola, mbrojtësi i Joves, që ka qenë i dëmtuar mund të nisë bisedimet me Torinon. Mbetet të shihet nëse do të kemi zhvillime të mëtejshme tek kjo pistë e komplikuar mes palëve apo jo.




**GRUAJA DHE AGJENTJA E IKARDIT**


**Vanda në sulm: Kush flet me mua duhet të ketë by...!**

Vanda Nara, agjentja e kapitenit të Interit, prej disa kohësh është në qendër të mediave italiane dhe jo vetëm, për ngërçin që Interi dhe Ikardi kanë për rinovimin e kontratës. Së fundmi ajo ka postuar një foto në rrjetin social "Instagram" me një mesazh të koduar.

"Më pëlqejnë personat që flasin tri gjuhë: ata që të flasin përballë, në mënyrë direkte dhe me by...", shkruante ai postim. Ky mesazh nuk dihet se kujt i drejtohet, pasi Vanda mund të themi që ka shumë kritikues. Të parët janë tifozët e Interit, më pas Interi. Nuk duhet të harrojmë këtu motrën e Ikardit që është e qartë që nuk e do kuanatën e saj. Gjithashtu, dhe intervistat e Maks Lopezit e kanë agravuar disi situatën mes tyre.



**Fjalëkryqi (1)**



- HORIZONTAL**  
 1. Mund të jetë e pasur me minerale.  
 7. Ascoli në tabela.  
 11. Një mund të jetë diplomatik.  
 12. Premtojnë të bëhen kampionë të tillë.  
 14. Janë felinë të egër.  
 16. Marubi i fotografisë.  
 18. Janë meduza.  
 19. Një anarkist i famshëm.  
 21. Smith filozof.  
 22. Susanna shkrimtare italiane.  
 23. Shkurt për company.  
 24. Organizma Autonome Kombëtare.  
 27. Mbarojnë punime.  
 28. Ndezur në aparaturë.  
 29. Bëjnë arte me re.  
 30. Nduket për gjysmë.  
 31. Mbyllin fushatat.  
 32. Luca bomber.  
 34. Emri i parë i Pasolini-t.  
 35. Një mund të jetë fetar.


37. Lidhen të parat.  
 38. Fundi i një faze.  
 39. Emri i Bismarck.  
 40. Kant e Diabolik.  
 42. Ze... në traget.  
 44. Entë Informacioni Rajonale.  
 45. Triolet e Trëndafili me kredi.  
 47. Rruge e Ferenc Molnar.  
 48. Në krye të notarëve.  
 50. Gjysmë tati.  
 51. Ushtrihet me cd false.
- VERTIKAL**  
 1. Numër i shkurtër.  
 2. Britame Arkimedit.  
 3. Iniciale e Paganini-t.  
 4. Fundi i Turandot.  
 5. Eshhtë fjetore ushtarësh.  
 6. Parker regjisor.  
 7. Kështu quhet që ushqim kundër intoksimit.  
 8. Një birrë e jona.  
 9. Mund të jenë përrimi.  
 10. Festat pa fat  
 11. Qendër ditore  
 13. Janë nomadë.  
 15. Fillojnë atletikën.  
 16. Eshhtë brinjë në skuadër.  
 17. Sidney i Serpico.  
 18. Qe centauri që mësonte Akilin.  
 20. Në mes të një kanali.  
 25. Bëhet për zakon.  
 26. Tregon martesë.  
 27. Një super... për shopping.  
 33. Vala e stadiumit.  
 34. Fillojnë poshtë.  
 36. Një provë... inteligjence.  
 38. Vaçe e famshme e këngës tonë.  
 41. Fillojnë vallen.  
 42. Para es Salaam.  
 43. Linearë pa larë.  
 46. Nota e diapzonit.  
 47. Mbyllin një shtëpi.  
 49. I keni në dorë.

**Fjalëkryqi (2)**

- HORIZONTAL**  
 1. Eshhtë skuadra e donatorëve  
 7. Mbyllin një turp.  
 9. Mund të jetë unik  
 11. Një i absurdit është i Samuel Beckett  
 14. Qyteti i përjetshëm.  
 15. Interpreton Sandokan.  
 17. I ka tek tenda.  
 18. Eshhtë këngëtar lirik  
 19. Arturo i Brecht.  
 20. John, i forti i Sylvester Stallone-s.  
 21. Françesku kantautor.  
 22. Eshhtë religjion politeist.  
 25. Qerre pa qe.  
 26. Gjysmë alarmi.  
 27. Eshhtë shtëpi i ZP.

30. Kush ka... ka zët.  
 31. Altini mesfushor.  
 32. Janë vajzat në atletikë.  
 34. Eshhtë shpend lagune.  
 36. Gjysmë thyese.  
 37. Udhëhoqi Argonautët.  
 39. Mund të jenë fotografikë të tillë.  
 40. Fillojnë panikun.

- VERTIKAL**  
 1. Janë çnjerëzore.  
 2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.  
 3. Edi në krye të PS.  
 4. Eshhtë lloj papagalli.  
 5. Fund turni.



6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.  
 7. Para devils për lojtarët e Manchester United.  
 8. U shkrua nga Kadare  
 10. Conan ai i Schwarzenegger.  
 11. Pak titanike.  
 12. Arbeni pa çifte.  
 13. I ka tek treni.  
 15. Mund të jenë pushimi  
 16. Mund të prishej nga je... kleçkë.  
 18. Në krye të bashkisë.  
 20. Eshhtë kundërshtar në dashuri  
 23. Meta në krye të LSI.  
 24. I vidhet ustait.  
 27. Jeppet e Artë në Cannes.  
 28. Eshhtë pije e jona.  
 29. Kufizojnë kënde.  
 31. Fillojnë lehtë.  
 33. Eshhtë dritëshkurtri.  
 35. Eshhtë numri i... të parit.  
 38. Fillojnë nazet.

**Gjeni ndryshimin**

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOK**

4							8		
		3	8				9		2
		7				1			4
					3			9	5
7									6
		5	2				4		
	6				7			1	
1				6			4	9	
				1					3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	9	4	8	1	5	2	3	6
1	6	2	7	4	3	8	9	5
3	5	8	9	2	6	1	4	7
2	7	6	3	8	9	4	5	1
8	1	5	4	6	2	3	7	9
4	3	9	1	5	7	6	8	2
9	2	1	5	3	8	7	6	4
5	4	3	6	7	1	9	2	8
6	8	7	2	9	4	5	1	3

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Argëtim filozofik*

- Pothuajse të gjithë ateistët kanë argumente për bindjet e tyre. Pothuajse asnjë fetar nuk ka argumente për bindjet e tij.

- Ai që ka një miq, shumë herë përpiqet për ti gjetur ata. Ai që ka një armik, e gjen kudo.

- Përvoja është një mësues i keq, sepse së pari ju vë në provë dhe pastaj ju jep një mësim.

- Lavdia është si rrethi në ujë. Vazhdimisht zjerrohet deri sa humbet.

*Thënie të mençura*

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

R	O	M	A	N	C	I	E	R	E	T	C		
I	R	O	N	L						T	R	U	P
T	R	T	A	R	T	A	R	E	T				
K	A	M	E	R	I	E	R	E	T				
D	E	L	I	R	A	N	T	E	T	P	R		
C		T	A	B	O	R		A	T	A			
K	R	I	P	E	A								
S	L	O	I	L	P			R	A	U	L		
T	A	N	T	A	L	I		U	R	R			
U	S	R	E	K	I	P	I		T	E			
F	A	T	A	L	A	L	I	E	N	E	T		
E	T	A	P	A	T			K	A	T	E	T	I

- Kur "qan" një ikonë bizantine, të gjithë nxitojnë ti afrohen asaj. Pyes veten se sa e bëjë të njëjtën gjë kur qan një njeri?
- Nëse ju gjithmonë thoni të vërtetën, ju nuk keni nevojë të mbani mend atë që keni thënë.
- TV nganjëherë është shumë edukative. Kur dikush pranë meje e ndez atë, shkoj për të lexuar një libër.
- Nëse ti bën një gabim, pranoje atë. Nëse nuk e pranon, sapo bërë një të dytë.

[www.sigal.com.al](http://www.sigal.com.al)



Android Apps on Google Play  
SIGAL UNIQA



**SIGAL**



UNIQA GROUP AUSTRIA

## Çfarë përfiton nga paga një individ nëse investon për Pension Privat?

Çdo individ i punësuar, i cili dëshiron të ketë një Pension Privat, përfiton përjashtimin nga taksa deri në vlerën 250 000 lekë nga paga e tij vjetore ose 20.800 lekë në muaj.

### PËRFITIMI NGA PENSIONI PRIVAT PËR PUNONJËSIT

**Për punonjësit me pagë bruto nga 30.000 deri në 130.000 lekë në muaj përfiton menjëherë 13% nga paga**

Investoni  
**5.000 Lekë/muaj**  
për Pension Privat

Kurseni 650 lekë në muaj  
(5.000 Lekë \* 13 %) ose

**7.800**  
Lekë në vit

Investoni  
**20.800 Lekë/muaj**  
Për Pension Privat

Kurseni 2.704 lekë/muaj  
(20.800 lekë \* 13 %) ose

**32.448**  
Lekë në vit

**20.800**  
Lekë/muaj  
Shuma maksimale që përjasohet nga Tatimi

**Për punonjësit me pagë bruto mbi 130.000 lekë në muaj përfiton menjëherë 23% nga paga**

Investoni  
**10,000 Lekë/muaj**  
për Pension Privat

Kurseni 2.300 lekë në muaj  
(10.000 Lekë \* 23 %) ose

**27.600**  
Lekë në vit

Investoni  
**20.800 Lekë/muaj**  
për Pension Privat

Kurseni 4.784 lekë/muaj  
(20.800 lekë \* 23 %) ose

**57,408**  
Lekë në vit

### Po një kompani çfarë përfiton nëse investon tek punonjësit e tij për Pension Privat?

Përveç përfitimit që ka vetë punonjësi edhe Biznesi **përfiton 1%** nëse investon për punonjësit e tij për Pension Privat.



Investimi në Pension e Privat është një mundësi e mirë për një pension të sigurtë dhe të ardhura të mjaftueshme për një jetë më të mirë gjatë kohës së pensionit.

Adresa: Qendra e Biznesit SIGAL, Blv. "Zogu I", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri - Tel: (+355) 4 2233 308 - e-mail: [info@sigal.com.al](mailto:info@sigal.com.al)